

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

DEPARTAMENTI: MËSIMDHËNIE E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE



PUNIM MAGJISTRATURE

TEMA: ANALIZA E DY ROMANEVE “SHKËLQIMI DHE RËNIA E SHOKUT ZYLO”
DHE “NJERIU ME TOP” NGA DRITËRO AGOLLI

Kandidatja:

Elfate Hasani

Mentori:

Prof. Dr. Zeqir Kadriu

Tetovë, 2019

Falënderim

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për mentorin Prof. Dr. Zeqir Kadriu për udhëzimet, këshillat e vlefshme dhe mbështetjen e vazhdueshme gjatë finalizimit të këtij punimi.

Dua të falënderoj të gjithë profesorët e Universitetit të Evropës Juglindore, të cilët kontribuan në arritjen time. Gjithashtu, u jam mirënjohëse kolegëve dhe personave të tjerë të cilët në një mënyrë apo tjetër kontribuan në arritjen time deri këtu.

Këtë punim ia dedikoj familjes sime që pa mbështetjen dhe durimin e të cilëve nuk do të ishte e mundur të finalizohet kjo punë. Dëshiroj ta falënderoj dhe t'i shpreh mirënjohjen bashkëshortit tim për përkrahjen e tij të palodhshme, djalit tim për durimin dhe motivin.

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të japë një zbërthim të tërësisë së ndërlikuar të romaneve “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo” si dhe “Njeriu me top”, nga Dritëro Agolli.

Studimi i letërsisë ndihmon për të formuar përvojën në bërjen e dallimit mes qëndrimit praktik e teorik mbi letërsinë. Veprën letrare të krijuar prej shkrimtarit, lexuesi e përjeton si art; në kuptim më të gjerë, edhe kritiku letrar, shpreh gjykimin e vet për këto vepra ose për themelet e tyre duke ndihur në krijimin e veprave të tjera. Me letërsi, në aspektin teorik merret ai që veprat letrare i studion si objekte të veçanta, brenda sistemit të veçantë të letërsisë, ai që e njeh natyrën e letërsisë në tërësi ose natyrën e ndonjë veprë letrare. Ndaj duhet bërë kujdes që të mos ngatërrohet qëndrimi teorik prej atij praktik ndaj letërsisë.

Struktura është parim i një ndërtimi dhe objekt i analizës. Analiza fillestare e këtij punimi, mbetet deri te niveli i dhënies së cilësisë së veprës letrare, duke synuar interpretimin e romaneve, gjatë të cilës caktohet kuptimi i tyre në tërësi si dhe roli i pjesëve të veçanta brenda tërësisë së tekstit letrar.

Si përfundim nga ky punim duke analizuar romanet, duhet të kuptojmë të paktën disa qëllime të autorit, që burojnë prej rrethanave në të cilat janë krijuar veprat.

Abstract

This paper is intended to provide a breakdown of the complexity of novels “The brightness and the fall of the comrade Zyló” and “The Man with the Cannon” by Dritëro Agolli.

Literature studies help to shape the experience of making the difference between practical and theoretical approach to literature. The literary work created by the writer, the reader experiences as art, in a broader sense, even the literary critic, expresses his own judgment of these works or of their foundations by helping to create other works. With literature, in the theoretical aspect deals he who the literary works are studied as special objects, within the particular system of literature, one who knows the nature of literature as a whole or the nature of any literary work. Therefore, care must be taken not to confused the theoretical attitude from the practical one to literature.

The structure is the one principle of a construction and object of analysis. The initial analysis of this work remains to the extent of the quality of the literary work, aiming at the interpretation of the novels, during which their meaning as a whole and the role of the particular parts within the whole of the literary text are defined.

As a conclusion from this paper by analyzing novels, we must understand at least some of the author's intentions stemming from the circumstances in which the works were created.

Përmbajtja

Abstrakt.....	3
Abstract.....	4
Hyrje	6
Qëllimet e punimit.....	8
Hipoteza	8
Metodologjia	8
Rëndësia e punimit.....	9
1. Jeta dhe vepra e Dritëro Agollit.....	11
1.1. Profili poetik i Agollit	18
2. Analiza e romaneve “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top”	22
2.1. Romani “Njeriu me top”	24
2.1.1. Analiza e personazheve.....	27
2.1.2. Ngjarja.....	30
2.1.3. Mesazhi	38
2.1.4. Kritika letrare për romanin.....	38
2.2. Romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”	40
2.2.1. Analiza e personazheve.....	45
2.2.2. Ngjarja.....	52
2.2.3. Mesazhi	53
2.2.4. Mjeti satirik: sarkazma.....	53
2.2.5. Kritika letrare për romanin.....	54
3. Krahasimi i dy romaneve.....	64
4. Vërtetimi i hipotezave	70
Përfundimi.....	73
Bibliografia	77

Hyrje

Dritëro Agolli është një nga figurat qendrore të poezisë shqipe dhe një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të brezit të viteve 1960. Krijimtaria e tij letrare është mjaft e pasur në gjini e lloje të ndryshme: poezi, poema, tregime, novela, romane, drama, skenarë filmash etj. Është fitues i disa çmimeve dhe i nderimeve të tjera. Disa prej veprave më të rëndësishme të tij janë përkthyer në Perëndim e në Lindje. Vepra letrare e Dritëro Agollit krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare. Ajo na bën të ndihemi me dinjitet përballë botës së madhe. Shkrimtar i madh i një "gjuhe të vogël", ai është po aq i dashur prej lexuesve bashkëkombës, sa dhe në metropolet e kulturës botërore.

Dritëro Agolli është njëri nga autorët më të njohur shqiptarë, i cili bëri bujë me veprimtarinë e tij letrare. Shkrimet e tij të para i përkasin periudhës së realizmit socialist, por nga shumica nuk konsiderohet si letërsi e angazhuar nga pushteti komunist.

Në këtë punim do të ndalemi në analizën ndërmjet dy romaneve “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” si dhe “Njeriu me top”, duke analizuar karakteristikat e këtyre dy romaneve, temat e trajtuara dhe çfarë i bën këto romane kaq të dashura për lexuesin. Do të analizojmë romanet për të kuptuar se çfarë mendimesh ka pasur autori, si është ndjerë ai për ngjarjet e kohës. Gjithashtu do të arrijmë në një përfundim se çfarë mendimi ka pasur autori për sistemin komunist e si mendon për rrëzimin e tij.

Dritëro Agolli dhe një rreth i ngushtë shkrimtarësh, bashkëkohanikë të tij, konsiderohen novatorët në letërsinë shqiptare të realizmit socialist. Cilët janë novatorë të kësaj krijimtarie. A është kjo letërsi vërtet novatore në shkallën që të sjellë përmbysje të madhe në mënyrën e trajtimit artistik të fenomeneve dhe dukurive shoqërore dhe jo vetëm.

Romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” është botuar në vitin 1973. Në të shkrimtari si objekt kryesor ka ndërtuar figurën e ironisë. Kjo do të thotë se kuptimi i përgjithshëm është i kundërt me atë që kumtohet drejtpërdrejt. Titulli i tij ka në qendër sintagmën shoku Zylo. Fjala shok, në sistemin socialist, kishte një kuptim moral dhe politik gjithmonë pozitiv, ndërsa në letërsi fitonte shpesh ngjyresa sublimë.

Romani “Njeriu me top” është botuar në vitin 1975, temë kryesore në këtë roman është lufta partizane. Në qendër të vëmendjes është hakmarrja e kryepersonazhit Mato Gruda, i cili është “në gjak” me fisin e Fizëve.

Vetë Dritëro Agolli ishte pjesë e nomenklaturës komuniste. Ai ushtronte detyra që nuk përjashtoheshin nga ndikimi shtetëror e ideologjik i asaj kohe. A është nostalgjik autori për kohët që perënduan apo është realist kur konstaton trazimet aq të thella shpirtërore të njerëzve të “kohës së re”, të kohës së ndryshimit.

Poezia në krijimtarinë e Dritëroit është gjëja më e çmuar, por jo e vetmja. Figura e Dritëroit si shkrimtar dhe njeri i kulturës është shumëdimensionale. Ai është sot mbas Kadaresë, shkrimtari shqiptar më i përkthyer në botë.

Në romanet e tij “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me Top”, me kurajo të admirueshme, Agolli i jep jetë kritikës sarkastike ndaj burokracisë tek i pari, dhe përkujtimit epik dhe ironik të heroizmit partizan në luftën kundër nazifashizmit tek i dyti.

Romanet e D. Agollit në ndërtimin e tyre ndjekin zakonisht rrugën e subjektit me një hero qendror, me një protagonist, dhe ngjarjet vijnë e thuren rreth tij. Temat dhe problemet kryesore që kanë tërhequr vëmendjen e autorit, lidhen me Luftën Nacionalçlirimtare, me ndryshimet në realitetin socialist, me dashurinë për tokën dhe për nënën Shqipëri, me luftën kundër moralit të huaj patriarkal e mikroborgjez dhe me pohimin e idealeve të komunizmit.

Në romanet “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top” do t’i përcjellim edhe me disa artikuj dhe thënie të shtypit të huaj për këto vepra. Autorë të artikujve dhe shkrimeve të tjera janë shkrimtarë dhe gazetarë mjaft të njohur si: Alen Boske, Ismail Kadare, Alter-ego: Dominik Fernandez, Fransua Nursie, Denis Zherar, Pierr Gamarra, Mari Fransuazë Alen si dhe rekomandimet e “Zylos” nga gazetatat dhe revistat si një ndër librat më të mirë. Këto shkrime besoj se i vlejné lexuesve për të njohur jehonën e këtyre dy romaneve edhe jashtë vendit si në Francë, Gjermani, Itali, Belgjikë, Zvicër e gjetiu. “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” si dihet, është përkthyer e botuar në Francë, në Gjermani, në Itali, në Rusi, në Greqi, në Bullgari... Edhe romani “Njeriu me top” është përkthyer, por jo aq sa “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, pra romani i Zylos mund të themi se është vlerësuar më shumë nga kritikët dhe është lexuar më shumë nga njerëzit e ndryshëm.

Qëllimet e punimit

Qëllimet e këtij hulumtimi janë:

- Të njihemi më mirë me autorin Dritëro Agolli dhe veprimtarinë e tij.
- Të thellohem më gjerësisht në analizën e dy romaneve “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” si dhe “Njeriu me top”.
- Të gjenden temat që trajtohen në këto romane.
- Të përcaktohen veçantitë e romaneve të këtij poeti dhe çfarë e bën atë autor kaq të veçantë dhe kaq të lexuar.
- Të analizojmë se ku është frymëzuar autori për të shkruar romanet si dhe çfarë qëllimi ka pasur, çfarë mesazhi ka dashur të dërgojë te lexuesi.

Hipoteza

Hipoteza 1: Në shoqërinë tonë hasim karakterin e Zylos.

Hipoteza 2: Te romani “Njeriu me top”, mesazhi kryesor është që shqiptarët t’i ndalojnë veprimet që dëmtojnë shtetin e tyre dhe veten (siç është gjakmarrja).

Hipoteza 3: Në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” Dritëro Agolli thumbon sistemin e asaj periudhe.

Metodologjia

Faza e kërkimit

Faza përgatitore

- studimi i romaneve “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” si dhe “Njeriu me top”
- formulimi i platformës studimore “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” si dhe “Njeriu me top” nga Dritëro Agolli

Faza e mbledhjes së të dhënave

- studimi i literaturës (kritika dhe analiza të shkruara për romanet e Dritëro Agollit)

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

- përqasja me studime të mëparshme
- analiza të thelluara mbi romanet në përgjithësi, motivet dhe temat
- përgjithësime dhe përfundime

Metodologjia e kërkimit

- Në bazë të qëllimit të punimit, metodologjia e kërkimit mbështetet në romanet e Dritëro Agollit.
- Romanet analizohen secila në veçanti dhe arrihet përfundimi.

Rëndësia e punimit

Dritëro Agolli është një autor me shumë vlera në letërsinë tonë. Romanet e tij edhe pse janë analizuar dhe komentuar shumë, gjithmonë kanë diçka të re për të diskutuar. Shumë studiues kanë folur mbi romanet e Agollit dhe vlerat e tyre.

Romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, mbetet ndër veprat më të arritura të Agollit, me plot mjeshtri dhe ironi therrëse ndaj burokracisë rrënuese që ndërtoi sistemi komunist. Ndonëse vetë shkrimtari është shprehur se me "Arkën e Djallit" do të ndryshojë përfytyrimin e letërsisë shqipe, për një shumicë lexuesish kontributi më i rëndësishëm letrar i tij në prozë është "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo".

Ndërsa për romanin “Njeriu me top”, Agolli edhe pse merr temën nga Lufta Nacionalçlirimtare (LNÇ), romani trajton çështje dhe ide të tilla që kanë të bëjnë me jetën ekzistenciale në tërësi. Romani shtron dhe analizon dashurinë dhe urrejtjen, fitoren dhe dështimin, egoizmin dhe idealet njerëzore.


Në këtë punim magjistrature do të analizohen të gjitha këto ndjesi të autorit, se çfarë ka dashur ai të thotë për këto dy romane, si është ndjerë për periudhën e socializmit, ndryshimet e kohës, ngjarjet që kanë ndodhur në atë periudhë etj.

“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” është përkthyer e botuar në Francë, në Gjermani, në Itali, në Rusi, në Greqi, në Bullgari... Edhe romani “Njeriu me top” është përkthyer, por jo aq sa “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, pra romani i Zylos mund të themi se është vlerësuar më shumë nga kritikët dhe është lexuar më shumë nga njerëzit e ndryshëm. Prandaj, mund të themi se këto dy vepra të Dritëro Agollit janë të një rëndësie të madhe.

Rëndësi të veçantë, gjithashtu kanë edhe mesazhet që i përcjellin këto dy romane, që janë të vlerësuara shumë, si nga vendi ynë, ashtu edhe nga vendet e tjera të botës.

1. Jeta dhe vepra e Dritëro Agollit

Dritëro Agolli (13 tetor 1931 - 3 shkurt 2017) - poet, prozator, publicist dhe politikan shqiptar.



Shkaku më i dukshëm i një vepre arti është krijuesi i saj, autori; prandaj dhe trajtimi sipas personalitetit dhe jetës së shkrimtarit ka qenë një nga metodat më të hershme e më të afirmuara të studimeve letrare. Për biografinë mund të flitet e të gjykohet për aq sa hedh dritë mbi vetë veprën e artit; por natyrisht ne e mbrojmë dhe e përlijim biografinë edhe si një studim për gjenin dhe talentin, për zhvillimin e saj moral, intelektual dhe emocional dhe kjo ka interesin e vet të brendshëm; më në fund themi se biografia jep materiale për një studim sistematik të *psikologjisë*¹ së shkrimtarit dhe të vetë procesit krijues.²

Vepra e Dritëro Agollit, emri i tij, si një prej shenjave referenciale të historisë së letërsisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të, është kërcëllitur nëpër dhëmbë, është mërmëritur e bërtitur, është vëzhguar e përplasur, pa pësuar atë humbje që shpresohet dhe madje mezi ç’pritej nga “kalorësit e çmistifikimit”.³

Krijimtaria e Dritëro Agollit zë një vend të rëndësishëm në letërsinë tonë të realizimit socialist. Ky autor është ndër më të shquarit që ka lëvruar lloje të ndryshme letrare, sidomos në fushën e poezisë dhe të prozës. Krijimtaria e shumanshme e D. Agollit, së bashku me krijimtarinë e autorëve të tjerë më të mirë, qëndron në radhët e para të letërsisë e të artit tonë

¹ Me “psikologji të letërsisë” mund të nënkuptojmë studimin e personalitetit të shkrimtarit si tip dhe si individ më vete; pastaj studimin e procesit krijues; pastaj studimin e tipologjisë psikologjike e të ligjësive të krijimit, të pranishme brenda veprave letrare, dhe më në fund, ndikimin e letërsisë të lexuesit (psikologjia e lexuesit).

² Rene, W., Austin, W., “Teoria e letërsisë”, Tiranë, 2007, fq. 57.

³ Sinani Sh., “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit, Tiranë, 2012, f. 46.

të ri, ku gjejnë pasqyrim dhe shprehje të gjallë realiteti socialist, e sotmja dhe historia shqiptare, idetë e partishmërisë më të lartë proletare dhe karakteri kombëtar.

Dritëro Agolli lindi më 13 tetor 1931 në Menkulas të Rrethit të Devollit afër Korçës dhe u nda nga jeta më 3 shkurt 2017 në Tiranë (në moshën 85 vjeçare ndahet nga jeta me një sëmundje kronike në mushkri por, ai do të mbetet një nga figurat më të shquara të penës shqiptare). Pasi mori mësimet e para në vendlindje, vazhdoi gjimnazin e Gjitokastrës, një shkollë me mjaft traditë. Ai vazhdoi studimet e tij në Fakultetin e Arteve në Shën Petersburg. Ka punuar shumë kohë gazetar në gazetën e përditshme "*Zëri i popullit*", dhe për shumë vjet ka qenë Kryetar i *Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë*. Për tridhjetë vjet me radhë Dritëro Agolli u zgjodh deputet. Krijimtaria e tij letrare është mjaft e pasur në gjini e lloje të ndryshme: poezi, poema, tregime, novela, romane, drama, skenarë filmash etj. Është fitues i disa çmimeve dhe i nderimeve të tjera. Disa prej veprave më të rëndësishme të tij janë përkthyer në Perëndim e në Lindje.⁴

D. Agolli filloi të shkruante duke qenë ende nxënës i shkollës së mesme, nga fundi i viteve 40 e fillimi i viteve 50. Botonte në organet letrare të asaj kohe: "*Letrari i ri*" e "*Letërsia jonë*", pra këto ishin poezitë e para. Vëllimin e tij të parë "*Në rrugë dola*" e botoi më 1958, pasi grumbulloi përvojë e kulturë. Pastaj ai botoi me radhë vëllimet e tij poetike me vjersha e poema: "*Hapat e mia në asfalt*", "*Shtigje malesh dhe trotuare*", "*Mesditë*", përmbledhjen me poezi të zgjedhura, romanin "*Komisari Memo*", poemën "*Nënë Shqipëri*", romanet "*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*" dhe "*Njeriu me top*", vëllimin poetik "*Fjala gdhend gurin*", si dhe krijime të tjera. Dritëro Agolli bën pjesë në brezin e shkrimtarëve që hyn në letërsi nga fundi i viteve 50, pikërisht atëherë kur do të niste një fazë pjekurie më e madhe në letërsinë tonë, një realizëm më i ndjeshëm dhe një sintezë më e dukshme midis përmbajtjes dhe formës, e cila shprehej me një cilësi më të lartë. Ky ishte brezi i shkrimtarëve të rinj të asaj kohe.⁵

Dritëro Agolli dhe brezi i tij letrar (vitet '60) nuk u paraqitën me ndonjë poetikë të re, sido që u diskutua mjaft edhe për rimën dhe ritmin, për vargun e lirë dhe vargun e rregullt, për "rreptësinë" e poezisë. Më shumë përvoja e tij krijuese, se traktatet teorike, bëri që të ndryshohej rrënjësisht tradita e vjershërimit shqip. Dritëro Agolli u shfaq në letërsi si një autor me kërkesa të larta për poezinë. Ai synoi një poezi më të përveçme, me më shumë

⁴ https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-2 (qasja e fundit më 10.10.2018)

⁵ Agolli, D., "*Poezi*", Tiranë, 1981, fq. 7

individualitet. Agolli krijoi poezinë e "un-it", përkundër poezisë së "ne-ve", që shkruhej "për të bashkuar masat". Agolli krijoi një model të ri vjershërimi në problematikë dhe në mjeshtërinë letrare, gërshetoi natyrshëm vlerat tradicionale të poezisë me mënyra të reja të shprehjes poetike. Thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet poezia e tij. Në prozën e tij Agolli solli risi vetëm në strukturën narrative, por dhe në galerinë e personazheve të veta. Ata janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë. Frazelogjia e pasur popullore dhe filozofia jetësore e bëjnë përgjithësisht tërë veprën letrare të Agollit sot për sot ndër më të lexuarën.⁶

Krijimtaria e Agollit, ashtu si gjithë letërsia jonë, shquhet për militantizmin e vet, për pasqyrimin e revolucionit tonë, të etapave të ndryshme të zhvillimit të tij. Veprat e këtij autori kanë pasur kurdoherë dhe kanë një prirje të dukshme drejt problemeve të mëdha dhe kyçe të historisë sonë kombëtare; ato vënë në qendër Luftën Nacionalçlirimtare, shndërrimet socialiste të jetës, formimin shoqëror dhe moral të njeriut, fshatin, qytetin, arat, malet.⁷

Temat dhe problemet kryesore që kanë tërhequr vëmendjen e autorit lidhen me Luftën Nacionalçlirimtare, me ndryshimet në realitetin socialist, me dashurinë për tokën dhe për nënën Shqipëri, me luftën kundër moralit të huaj patriarkal e mikroborgjez dhe me pohimin e idealeve të komunizmit.⁸

Në romanet e tij "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" dhe "Njeriu me Top", me kurajo të admirueshme, Agolli i jep jetë kritikës sarkastike ndaj burokracisë tek i pari, dhe përkujtimit epik dhe ironik të heroizmit partizan në luftën kundër nazifashizmit tek i dyti.

Vepra letrare e Dritëro Agollit krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare. Ajo na bën të ndihemi me dinjitet përballë botës së madhe. Shkrimtar i madh i një "gjuhe të vogël", ai është po aq i dashur prej lexuesve bashkëkombas, sa edhe në metropolet e kulturës botërore. Dritëro Agolli dhe brezi i tij letrar (vitet '60) nuk u paraqitën me ndonjë poetikë të re, sido që u diskutua mjaft edhe për rimën dhe ritmin, për vargun e lirë dhe vargun e rregullt, për "rreptësinë" e poezisë.⁹

⁶ https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-GjSh-4 (qasja e fundit më 18.10.2018)

⁷ Agolli, D., "Poezi", Tiranë, 1981, f.f. 8-9.

⁸ Agolli, D., "Poezi", Tiranë, 1981, f. 20.

⁹ Kuçuku, B., "Bota poetike e Dritëro Agollit", në revistën Studime filologjike, 1991/1, f. 151-160.

Dritëro Agolli dhe një rreth i ngushtë shkrimtarësh, bashkëkohanikë të tij, konsiderohen novatorët në letërsinë shqiptare të realizmit socialist. Cilët janë novatorë të kësaj krijimtarie. A është kjo letërsi vërtet novatore në shkallën që të sjell përmbysje të madhe në mënyrën e trajtësimit artistik të fenomeneve dhe dukurive shoqërore dhe jo vetëm.

Vepra e tij poetike më e shquar është *“Nënë Shqipëri”* (1975), ku krijohet figura e Atdheut me traditat heroike, me vështirësitë e shumta që ndeshi në rrugën e vet dhe me vendosmërinë për të përballuar çdo pengesë e armik. Në poemën *“Baballarët”* theksohet rëndësia e veçantë e vijimësisë së traditave revolucionare në jetën e shoqërisë. Në një sërë vjershash dhe poemash Dritëro Agolli pasqyron frymën heroike të periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare (Poema e udhës, Poemë për babanë dhe për vete etj...). Në prozë bëri emër sidomos romani *“Komisari Memo”* (1969), në të cilin pasqyrohet roli i madh edukues dhe drejtues në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare. Nga ngjarjet e kësaj periudhe e merr subjektin edhe romani *“Njeriu me top”* (1975), që flet për ndikimin e luftës çlirimtare në mentalitetin e njerëzve. Dritëro Agolli ka botuar edhe mjaft tregime e novela nga jeta e sotme. Ndër krijimet satirike romani *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”* (1973) vë në lojë konformizmin, servilizmin dhe vanitetin si shfaqje të huaja për njeriun e ri. Në vitin 2011 Dritëro Agolli, është nderuar me titullin doktor Honoris Causa nga Universiteti Evropian i Tiranës. Në një ceremoni të veçantë, iu dha ky titull shkrimtarit të shquar “Për kontributin e madh dhe të rëndësishëm në krijimtarinë e tij letrare për më shumë se 60 vjet, si poet, prozator, dramaturg përkthyes e eseist”.¹⁰

Gjuhëtari E. Lafe shkruan se “Pena e Dritëroit ka dhuntinë magjike që ta ndjellë lehtë dhe pa mundim, kuptimisht dhe stilistikisht dhe të mos kënaqet me të përafërtën. Kjo është fjala që gdhend gurin (siç e ka quajtur vetë në një përmbledhje të tij poetike), fjala që gdhend në kujtesën tonë shkrimtarësinë e Dritëroit”¹¹

Leksiku në veprën e Agollit përfshin njësi të njohura, pak të njohura a të panjohura dhe mund të vështrohet nga disa anë. Autori shquhet për njohjen e thellë leksikore e semantike të shqipes dhe ai jo vetëm i përdor fjalët shqipe me mjeshtëri, por edhe ripërtërin pasurinë e madhe që ka gjuha shqipe. Ai shquhet për njohje të thellë të mundësive dhe aftësive të mëdha të shqipes për krijimin e njësive të reja dhe vetë krijon me qindra e qindra. Gjovalin Shkurta

¹⁰ https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-GjSh-4 (qasja e fundit 20.10.2018)

¹¹ E. Lafe, *“Ditëro Agolli, mjeshtër i fjalës shqipe”*, “Telegraf”, 13 tetor 2011.

shprehet: *“Dritëro Agolli fjalëkrijimin e ka si një mjeshtëri së cilës i prijnë qëmtimi e mbledhja e fjalës së bukur shqipe që ka populli dhe tradita e mëparshme letrare”*.¹²

Te romani me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare, “Njeriu me top”, shohim që janë përdorur me vend dhe me masë fjalë të vjetëruara me vlera stilistikore. Në vartësi të kohës nga e cila i marrin ngjarjet që përshkruajnë në vepra, autorët, ne gjejmë edhe raporte të ndryshme të përdorimit të historizmave ose arkaizmave. Kështu, po të ndalemi te romanet që flasin për të kaluarën e largët janë përdorur më shumë arkaizma dhe më pak historizma, te të tjerat që i drejtohen të kaluarës së afërt ose Luftës Nacionalçlirimtare ka ndodhur e kundërta. Te këto të fundit gjejmë historizma të tillë si: *njësit, gueril, etj... dhe e thërresin babanë dy fshatarë me pushkë nga ata të njësitit partizan të fshatit*.¹³

Agolli si një prej autorëve të lidhur ngushtë me krijimtarinë popullore përdor dendur si mjet shprehës krahasimin. Krahasimi është në themel të mjetit të shprehjes edhe kur në të nuk del i shprehur gjuhësisht mjeti krahasues, duke krijuar një numër të madh mjetesh që qëndrojnë midis krahasimit e metaforës.¹⁴ Agolli me anë të krahasimit sjell një pasuri të madhe gjuhësore e stilistike, shpesh ato janë të gjalla e të huajtura nga jeta e përditshme. Përfundimisht mund të themi se Dritëro Agolli, mbetet një nga individualitetet më të spikatur, i cili shfrytëzoi gjuhën e gjallë të popullit për të përçar ndjesitë dhe përjetimet personale. Pa diskutim ai përpunoi me mjeshtëri fjalë e kuptime të përdorura në gjuhën e gjallë, por i pasuroi ato me kuptime dhe kalime kuptimore të reja. Vepra e Agollit shquhet për një sistem të pasur e tepër të larmishëm të figurshmërisë, bota shqiptare jepet në lëvizje me figurshmëri konkretizuese, e kombinuar me imazhe dëgjimore e imazhe pamore piktoriale.¹⁵

Dritëro Agolli, edhe pse në rolin e tij për njëzet vjet President i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe më pas anëtar i Parlamentit, gëzon një famë të tejskajshme në vendin e tij, që e ka dashur dhe e do me mjaft dhembshuri.¹⁶

Peter Constantine thekson: Një autor që meriton të zbulohet nga bota angleze është Dritëro Agolli, i konsideruar nga shumë shqiptarë si romancieri dhe poeti më i mirë i vendit të tyre.

¹² Shkurtaj, Gj., *“Disa tipare të ligjërit poetik të D. Agollit”*. Gazeta “Drita”, 19 prill, 1987, fq. 12.

¹³ Shaban, Sh., *“Njerëzit e krisur”* të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë, 2012, fq. 92

¹⁴ Thomai, J., *“Rreth prejardhjes semantike të fjalëve në gjuhën shqipe”*, f. 150.

¹⁵ Universiteti “Eqrem Çabej”, *“Dritëro Agolli- Personalitet i shquar i letërsisë dhe kulturës shqiptare”*, Gjirokastër, 2013.

¹⁶ http://www.oranews.tv/article/urime-e-cmime-ne-prag-te-pervjetorit-dritero-agolli-merr-carlo-levi-ne-82-vjetor?fbclid=IwAR0CBADMiU5GZ6HSGoAhCDgTrE3_6_53GhceweTnweGQoAnj0PyS2AlolPw (qasja e fundit më 01.10.2018)

Ashtu si bashkatdhetari më i famshëm Ismail Kadare, i cili është përkthyer gjerësisht në anglisht, Agolli ka lindur në Shqipërinë Jugore (pesë vjet para Kadaresë, në vitin 1931). Agolli dhe Kadare konsiderohen në përgjithësi shkrimtarët më të shquar të Shqipërisë në epokën moderne, Agolli ishte shitës më i madh përpara rënies së diktaturës brutale të Enver Hoxhës në vitin 1991, e cila kishte izoluar dhe mbyllur Shqipërinë nga bota e jashtme për shumë dekada. Gjatë viteve më të errëta të diktaturës Agolli ishte president i Bashkimit të Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe një deputet në Asamblenë Popullore, pozicionet që më pas e përndiqën. Prerja e tij gjatë një epoke kur shumë autorë shqiptarë u dërguan në kampet brutale të burgjeve është ende një çështje. Por ajo që është më e shquar në shkrimet e Agollit dhe Kadaresë është se gjatë viteve të censurës më të ashpër dhe më kufizuese, të dy arritën të shkruanin romane të thella e të fuqishme, megjithëse duhet të shmangnin një listë të pafundme të temave të pahijshme dhe të pakontrollueshme. Romani i parë Agolli që unë do të propozoja për përkthim është “Njeriu me top”, i cili në fakt u shfaq në një version të dobët dhe jo të plotë nga Shtëpia Botuese 8 Nëntori e Shtetit Shqiptar në vitin 1983. Të tjera romane të rëndësishme Agolli janë “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Komisari Memo”, i cili u shfaq edhe gjatë epokës së diktaturës në atë që është më shumë se një parafrzim se sa një përkthim i botuar nga 8 Nëntori Shtëpia Botuese si Bustin e Bronzit. Punimet e Dritëro Agolli meritojnë një lexues më të gjerë dhe një përkthim që kap elegancën dhe fuqinë e prozës së tij.¹⁷

Titujt e veprave

- Në rrugë dola, 1958
- Hapat e mia në asfalt, 1961
- Zhurma e erërave të dikurshme, 1964
- Shtigje malesh dhe trotuare, 1965
- Mesditë, 1969
- Komisari Memo, roman, 1969
- Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo, roman, 1973

¹⁷ <http://quarterlyconversation.com/peter-constantine-on-njeriu-me-top-the-man-with-a-gun-by-dritro-agolli>

- Njeriu i mirë, tregime, 1973
- Nënë Shqipëri, 1974
- Njeriu me top, 1975
- Fjala gdhend gurin, 1977
- Trëndafili në gotë, roman, 1980
- Fytyra e dytë, dramë
- Mosha e bardhë (dramë)
- Udhëtoj i menduar, 1985
- Pelegrini i vonuar, 1993
- Kalorësi lakuriq, roman, 1996
- Vjen njeriu i çuditshëm, poezi, 1996
- Arka e djallit, roman, 1997
- Teshtimat e lirisë: njeriu, politika dhe kultura, 1997
- Fletorka e mesnatës, 1998
- I përndjekuri i dashurisë, poezi, 2013
- Prit edhe pak, poezi, 2016
- E bukura, lozonjarja, tokësorja Grua, poezi, 2017
- Nulla dies sine linea, aforizma, 2017¹⁸

¹⁸ https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-GjSh-4 (qasja e fundit më 23.10.2018)

1.1. Profili poetik i Agollit

Dritëro Agolli është poeti ynë më fshatar dhe më shqiptar, nëse mund të themi kështu, ndonëse ai është njëkohësisht poet me kulturë e horizont të gjerë, madje njëri nga poetët tanë më të kulturuar – njohës i mirë i rrjedhave të poezisë botërore dhe përkthyes i disa prej poetëve të shquar të këtij shekulli, siç janë: Jesenini, Majakovski, Lorka, Elyari, Bagricki etj., i poezisë së poetit skocez të shek. të 18-të. Robert Bërns; i poetit amerikan të shek. të 19-të, Uollt Uitman etj.¹⁹

Poet që krahas vargjeve, vjershave, poemave etj., ka shkruar edhe artikuj kritikë për problemet e ndryshme të artit dhe të letërsisë, duke u kujdesur t'i njohë lexuesit e vet edhe me pikëpamjet e tij për poezinë apo për letërsinë në përgjithësi, vetë Dritëro Agolli, në një artikull të hershëm të botuar në “Nëntori”, shkruan:

*“Poezia (...), si çdo art tjetër, duhet t’u flasë zemrave dhe të bëhet e nevojshme si ajri, uji dhe buka”*²⁰

Tipizimi i heroit lirik: Ç’është “heroi lirik” dhe ç’funksion ka ai në poezinë e Dritëro Agollit? Sipas mendimit të Dritëro Agollit heroi lirik është një instrument, me anën e të cilit poeti shpreh ndjenjat dhe mendimet e njeriut të kohës, transformimet që ndodhin në shoqëri dhe proceset historike.²¹

Në poezinë e Dritëro Agollit hasen: tema e luftës dhe e revolucionit; tema e tokës dhe e atdheut; tema e natyrës dhe e dashurisë; tema e punës dhe e transformimeve socialiste të vendit; tema e luftës për emancipimin e gruas dhe e luftës kundër kanunit; tema e luftës kundër mentalitetit mikroborgjez dhe në përgjithësi e marrëdhënieve etiko-morale; tema e fshatit, e vendlindjes dhe e fëmijërisë; tema e kalueshmërisë së jetës dhe tema e vdekjes, si edhe një varg temash e motivesh të tjera, të cilat takohen, gërshetohen e plotësohen reciprokisht.

¹⁹ Vinca, A., “Orët e poezisë”, Prishtinë, 2010, fq. 140.

²⁰ Agolli, D., “Disa probleme të poezisë së letrarëve të rinj”. “Nëntori”, Tiranë 1964, nr. 7. fq. 55

²¹ Vinca, A., “Orët e poezisë”, Prishtinë, 2010, fq. 152.

Dritëro Agolli është poet që e karakterizon para se gjithash prirja për ta kapur jetën në lëvizje dhe për të zbuluar momentet poetike të realitetit, anët me potencë ideoemocionale e filozofike. Në vjershën “*Kur libri është në shtyp*” ai tregon se si poeti nuk është i qetë as kur e dorëzon librin në shtyp, sepse para syve të tij ndodhin shumë gjëra, të vogla e të mëdha. Para syve të poetit ndodh jeta, të cilën ai dëshiron ta transponojë në poezi: diku ngrihet një digë betoni, në një fshat elektrikisti llambën e fundit lidh, diku në një rrugë një vajzë ecën e dashuruar, në një fushë lule mbush kërcellin me fletë.²²

Në poezinë e Dritëro Agollit jepen në një unitet të plotë të gjitha temat, ai ato shoqërore, ashtu edhe ato intime, sikundër edhe përbërësit e saj kryesorë: objekti (realiteti shoqëror), subjekti (heroi lirik, poeti), raportet ndërmjet tyre dhe gjykimi ideoartistik i këtyre raporteve.²³

Rezervat e pashtershme të fjalës: Duke qenë poet që mban qëndrim të hapur e dialektik, domethënë krijues ndaj jetës, natyrës dhe shoqërisë, domethënë ndaj materies të cilën e bën objekt trajtimi poetik, është e natyrshme që Dritëro Agolli të mbajë qëndrim krijues edhe ndaj mjeteve me të cilat e trajton atë materie: ndaj gjuhës, fjalës dhe shprehjes poetike.²⁴ Dritëro Agolli është poet që e zotëron mirë artin e vështirë për të bërë vargje të lehta, siç thoshte Bualoi. Me fjalë të tjera, ai është poet që shkruan thjesht, por pa rënë në thjeshtëzim. Poezia e tij është e qartë, e thjeshtë dhe e bukur, asociative dhe sugjестive. Dhe mbi të gjitha tejet e hapur dhe komunikative. Agolli është pa dyshim poeti më komunikativ dhe më spontan “edhe nga fshatarët”, edhe nga “universitarët”.²⁵

Dritëro Agolli është poeti i kohës sonë që, më shumë se kushdo tjetër, ka mundur të përfitojë nga vlerat e larmishme dhe përvoja estetike e gurrës popullore.²⁶

Mund të themi se Dritëro Agolli e vazhdon me sukses udhëtimin e tij poetik, kurse poezia e tij e ruan freskinë dhe blerimin e patharë, duke i ruajtur përherë lidhjet e forta me jetën, natyrën dhe shoqërinë.

²² Vinca, A., “*Orët e poezisë*”, Prishtinë, 2010, fq. 157.

²³ Brahimi, R., “*Kur flasim për poezinë*”, Tiranë, 1972, fq. 162.

²⁴ Vinca, A., “*Orët e poezisë*”, Prishtinë, 2010, fq. 159.

²⁵ Brahimi, R., “*Kur flasim për poezinë*”, Tiranë, 1972, fq. 135.

²⁶ Uçi, A., “*Problem i mitit në letërsinë e realizimit socialist*”. “*Nëntori*”, 1980, nr. 3, fq. 142.

Poezia në krijimtarinë e Dritëroit është gjëja më e çmuar, por jo e vetmja. Figura e Dritëroit si shkrimtar dhe njeri i kulturës është shumëdimensionale. Ai është sot mbas Kadaresë, shkrimtari shqiptar më i përkthyer në botë.

Poema është një gjini shumë e lëvruar nga Dritëro Agolli. Motivet dhe problematika e poemave ka të bëjë me tërë krijimtarinë poetike të autorit. Ka tema që rimerren nga një vjershë, zgjerohen e thellohen. Është e natyrshme se brenda “botës poetike” të një autori, sikundër përgjithësisht brenda “botës artistike të një krijuesi, do të gjenden tipare e profile të caktuara, të pëlqyera prej tij, që i japin edhe fizionominë, edhe përmbajtjen krijimtarisë. Këto tipare janë të dallueshme në veprën e Dritëro Agollit dhe lexuesi njihet, “miqësohet” me njerëzit, lidhet me episode dhe meditime që gjenden në të.

Proza artistike dhe publicistike letrare zënë gjithashtu një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e Dritëro Agollit. Duke shprehur prirjet realiste të prozës sonë në vitet 60 e 70, në gjurmët e arritjeve më të mira të mëparshme, proza e Dritëro Agollit, së bashku me atë të J. Xoxës, I. Kadaresë, S. Spasses, F. Gjatës, Dh. Xhuvanit e të tjerëve pasuroi gjininë e romanit, kontribuoi në pasqyrimin më të plotë e me vërtetësi të jetës, sidomos të Luftës Nacionalçlirimtare, në skalitjen e karaktereve dhe në pasurimin e stileve dhe të gjuhës artistike.

Agolli krijoi një model të ri vjershërimi në problematikë dhe në mjeshtërinë letrare, gërshetoi natyrshëm vlerat tradicionale të poezisë me mënyra të reja të shprehjes poetike. Thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet poezia e tij.²⁷

Dritëro Agolli është personalitet i shquar i shoqërisë shqiptare dhe i letrave shqipe. Ai është pa diskutim zëri më përfaqësues i viteve 60’, ai është poet, prozator, publicist, eseist, kritik, shqipërues, dramaturg. E gjithë veprimtaria e tij artistike krijuese është pasqyrim artistik i asaj periudhe historike që nis në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar e që Dritëro Agolli e ka jetuar në mënyrë aktive.

Agolli ishte shkrimtari i filozofisë dhe i dhimbjes njerëzore, gërshetoi shumë bukur natyrshëm vlerat tradicionale me mënyra të reja të shprehjes artistike. Thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet krijimtaria agolliane. Në prozën e tij Dritëroi solli risi jo vetëm në strukturën

²⁷ Klara Kodra, Bota poetike e Dritëro Agollit , revistën Studime filologjike, 2012/1-2, f. 59-72.

narative, por edhe në galerinë e personazheve të veta. Personazhet e Agollit janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë.

2. Analiza e romaneve “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top”

Në prozë bëri emër sidomos romani “Komisari Memo” (1969), në të cilin pasqyrohet roli i madh edukues dhe drejtues në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare. Nga ngjarjet e kësaj periudhe e merr subjektin edhe romani “Njeriu me top” (1975), që flet për ndikimin e luftës çlirimtare në mentalitetin e njerëzve. Ndër krijimet satirike romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” (1973) vë në lojë konformizmin, servilizmin dhe vanitetin si shfaqje të huaja për njeriun e ri.²⁸

Romanet e D. Agollit në ndërtimin e tyre ndjekin zakonisht rrugën e subjektit me një hero qendror, me një protagonist, dhe ngjarjet vijnë e thuren rreth tij. Temat dhe problemet kryesore që kanë tërhequr vëmendjen e autorit, lidhen me Luftën Nacionalçlirimtare, me ndryshimet në realitetin socialist, me dashurinë për tokën dhe për nënën Shqipëri, me luftën kundër moralit të huaj patriarkal e mikroborgjez dhe me pohimin e idealeve të komunizmit.

Në romanet e tij “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me Top”, me kurajo të admirueshme, Agolli i jep jetë kritikës sarkastike ndaj burokracisë tek i pari, dhe përkujtimit epik dhe ironik të heroizmit partizan në luftën kundër nazifashizmit tek i dyti.

Në këtë pjesë të punimit do të analizojmë romanet për të kuptuar se çfarë mendimesh ka pasur autori, si është ndjerë ai për ngjarjet e kohës. Gjithashtu do të arrijmë në një përfundim se çfarë mendimi ka pasur autori për sistemin komunist e si mendon për rrëzimin e tij. Ky punim është një përpjekje modeste për të dëshmuar edhe një herë se brenda formësimit aktual dhe praktik të shenjave gjuhësore “fshihet” një botëkuptim i caktuar, i cili shpreh cilësitë shpirtërore të popullit që e flet dhe se gjuha është një realitet mendësor, kulturor, etnografik, historiko-shoqëror. Lidhja e veshjes tingullore me bazën sendore-logjike është çështje përceptimi, reflektimi, botëkuptimi dhe se ndërliqësia e procesit krijues, me të cilin gjuhët përballen çdo ditë, buron së brendshmi nga dëshira që ka çdo bashkësi dhe kulturë për ta vulosur realitetin sipas mënyrës së vet.

Por ajo çka kuptohet nën këtë term është shumë më e gjerë dhe është shtruar e hulumtuar që së lashti. Nga shumica e gjuhëtarëve dhe e filozofëve të gjuhës është pranuar se gjuha nuk

²⁸ https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-GjSh-4 (qasja e fundit më 01.11.2018)

duhet parë si një produkt i vdekur (pa jetë), por si një proces krijues, ajo funksionon si një mjet komunikimi dhe ka një lidhje të fortë me veprimtarinë e brendshme shpirtërore. Thelbin e formës së brendshme të gjuhës e ka përimtuar për bukuri Sh. Rrokaj, kur shkruan:

- “Gjuha e një bashkësie nuk është vetëm një mjet i thjeshtë komunikimi, një rregullator i marrëdhënieve të gjithanshme shoqërore, ajo është një mjet që jep mundësinë për formimin e botëkuptimit të individit si pjesëtar i bashkësisë, si dhe shpreh gjithë zbërthimin e qenies së tij shpirtërore. Veçanësia e një gjuhe në raport me një tjetër, krahas dallimeve të njohura, qëndron edhe në faktin se çdo gjuhë përfaqëson në mënyrë shumë origjinale se si pjesëtarët e bashkësisë folëse perceptojnë marrëdhëniet e gjithanshme, nga ato ekzistenciale deri ato etnokulturore. Vetëm në gjuhën e tyre vlerat shpirtërore të një populli gjejnë mënyrën më të mirë të shprehjes, sepse ato nuk janë të krijuara jashtë kësaj gjuhe”²⁹

Personazhet e Agollit janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë.

Te romani me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare, “Njeriu me top”, shohim që janë përdorur me vend dhe me masë fjalë të vjetëruara me vlera stilistikore. Në vartësi të kohës nga e cila i marrin ngjarjet që përshkruajnë në vepra, autorët, ne gjejmë edhe raporte të ndryshme të përdorimit të historizmave ose arkaizmave. Kështu, po të ndalemi te romanet që flasin për të kaluarën e largët janë përdorur më shumë arkaizma dhe më pak historizma, te të tjerat që i drejtohen të kaluarës së afërt ose Luftës Nacionalçlirimtare ka ndodhur e kundërta. Te këto të fundit gjejmë historizma të tillë si: *njësit, gueril, etj... dhe e thërresin babanë dy fshatarë me pushkë nga ata të njësitit partizan të fshatit*.³⁰ Ndërsa te romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” gjejmë disa neologjizma të krijuara me përbërje, të cilat i përkasin stilit zyrtar administrative si: *fjalëshkëmbimi, raportshkruesi, karakterdobëti, moralprishur, mirëdashësi*.³¹

²⁹ Rrokaj, Sh., “Çështje të gjuhës shqipe 1”, Albatros, Tiranë, 2007, f. 263.

³⁰ Shaban, Sh., “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë, 2012, fq. 92

³¹ T.Osmani, M.Gero, “Mendime për gjuhën dhe stilin e Dritëro Agollit”, Gjuha jonë, 1, Tiranë, 1991

2.1. Romani “Njeriu me top”

Dritëroiti i kishte rënë në dorë nga një mik i tij gazetar, një fletore e trashë me kapakë të zinj. Një nxënës kishte shkruar historinë e fisit të tij, të treguar nga gjyshi i moçëm, fis ky në fshatin Arapaj të Dibrës, në krahinën e Muhrit. Fletorja përmbante histori tragjike të lidhur me gjakmarrjen. Dritëroin e kishin tërhequr shumë ngjarjet që përshkruheshin në fletore shkurt dhe sidomos historia e topit të fshehur në shtëpi për hakmarrje ndaj një fisi të madh.³²

Te romani me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare, “Njeriu me top”, shohim që janë përdorur me vend dhe me masë fjalë të vjetëruara me vlera stilistikore. Në vartësi të kohës nga e cila i marrin ngjarjet që përshkruajnë në vepra, autorët, ne gjejmë edhe raporte të ndryshme të përdorimit të historizmave ose arkaizmave. Kështu, po të ndalemi te romanet që flasin për të kaluarën e largët janë përdorur më shumë arkaizma dhe më pak historizma, te të tjerat që i drejtohen të kaluarës së afërt ose Luftës Nacionalçlirimtare ka ndodhur e kundërta. Te këto të fundit gjejmë historizma të tillë si: *njësit, gueril, etj... dhe e thërresin babanë dy fshatarë me pushkë nga ata të njësitit partizan të fshatit*.³³

ANESTI NAÇI për romanin “Njeriu me top” thekson: Një Itali e prurë origjinalisht është ajo e Dritëro Agollit te romani “Njeriu me top”, i ndërtuar mbi temën dhe mitin e shpëtimit dhe mbajtjes së ushtarëve italianë nëpër shtëpitë e fshatarëve mbas 8 shtatorit tragjik të asaj «ushtri mavrie» siç e quan Mato Gruda (Agolli 2000: 84). Këtu ndërthurja dhe afërsi-diversiteti mes popujve dhe kulturave jepet mrekullueshëm ndërmjet një humori popullor unik. Ushqimi ose mishi i fukarait, “fasulja” te ne dhe “makaronet” tek italianët, tregojnë ndryshime dhe njëkohësisht afrojnë kulturat dhe popujt. Augusto, italian i Agollit qan, por jo si i keq apo thjesht frikacak, por si i mirë e i urtë, i vogël përballë tmerrit gjigant të një lufte të pashpjegueshme, por gjithsesi Mato Gruda edhe pse «nuk i pëlqente burrat që qajnë, nuk e përbuzi italianin» që shpesh ngashëronte i mbledhur në vetvete, «por e vështronte me keqardhje» (Agolli 2000: 97). Autori bën të kuptohet se si fjala “italiani”, gjatë gjithë periudhës në të cilën është ambientuar romani, ishte plasmuar me figurën e atij që bridhte nëpër Shqipëri duke kërkuar strehë, mëshirë dhe paqe, ku bujaria e shqiptarit, edhe pse shpesh arrogant, injorant e dyshues duke e nëpërkëmbur, nuk i mungoi. «Italiani i ngordhur që...do të marrë një hu e do ta zhdëp mirë – i thotë Zara Mato Grudës, dhe vazhdon – pastaj ti vetë më ke thënë që ata janë pushta» (Agolli 2000: 70). Paburrëria, aq sa mund t’i rrahin dhe

³² Agolli, D., “Njeriu me top”, Tiranë, 2000, fq. 301.

³³ Shaban, Sh., “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë, 2012, fq. 92

gratë dhe feminizmi jepen si “karakteristikat” kryesore të tyre. Por për Maton ata janë punëtorë, bile «ta kemi si shërbëtor – thotë – se italianëve, ç’u sheh syri u bën dora» (Agolli 2000: 73). Por, bashkë me konsideratën dhe humanizmin që u vihet në dukje, shpesh notat e poshtërimit dhe ofendimit kundër tyre, që rrjedhin prej situatës në të cilën ndodheshin, janë të shumta, duke filluar që prej emrit: Mato qysh në fillim e thërret Agush, e jo në emrin e vet Augusto. Armiqësi-miqësia jepet nëpërmjet një dialogu interesant, kur Augusto thotë se po të vinte dhe Mato në Itali, edhe ai kështu do ta kishte pritur e shpëtuar. «Ti nuk do të më prisje kështu, se unë nuk do të vija me pushkë si ti» i përgjigjet Mato Gruda (Agolli 2000: 98). Në këtë roman jepet në mënyrë magjistrale diferenca fatkeqësisht e vërtetë në shkollim dhe kulturë mes italianit dhe fshatarit shqiptar. Nga njëra anë ekzagjerimi i Matos fryt i mbylljes së tij – «që thua ti, as ky Dantja s’i ka parë në ëndërr ato historira që di unë» dhe nga tjetra konstatimi i së vërtetës së hidhur kur sheh ditarin e Augustos: «Evropa shkruan, ne mezi dimë të bëjmë dy kërraba» (Agolli 2000: 189). Dhe ja pra, italianët nëpër fshatrat e Shqipërisë të humbur e të harruar, vuajtës fatesh më të mëdhenj se ta, qofshin gjithsesi të ligj, apo frikacakë, qeflinj femrash apo njerëz të mirë, ngelen përfaqësues të një kulture që është për Mato Grudën, dhe në përgjithësi për shqiptarët “Evropë”. Te “Njeriu me top” afrimiteti mes njeriut italian dhe shqiptar, ngjashmëria e pamendueshme mes kulturave sillet prej autorit me një gjetje gjeniale e paradoksale, nëpërmjet diversitetit dhe kontrasteve në figurat kryesore të Matos dhe Augustos.³⁴

Përshkrim i shkurtër i romanit “Njeriu me top”: Është një roman historik, i cili ka të bëjë me luftën partizane. Ky roman sjell një ngjarje menjëherë pas tërheqjes së ushtrisë fashiste të Musolinit dhe ardhjes së nazistëve. Mato Gruda (kryepersonazhi) një fshatar që është në hasmëri me fisin e Fizëve, e veçanërisht plakun Mere Fizi. Pas betejës së humbur, Mato Gruda gjen një top të braktisur nga ushtria italiane, Mato e fsheh topin dhe ëndërron ta përdorë kundër plakut Mere. Pas kapitullimit të Italisë fashiste, Mato merr në shtëpi një italian si rob, të cilin ai e thërret Agush dhe prej tij mëson përdorimin e topit.

Tema: Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare.

³⁴ Anesti, N., “ITALIA, ITALIANËT DHE ITALIANITETI NË LETËRSINË SHQIPTARE TË PERIUDHËS SË KOMUNIZMIT”, AKTET Vol. VI, Nr 4, 2013, fq. 363

Analizë: Romani i dytë mbi Luftën i Dritëro Agollit “*Njeriu me top*” (1975) dëshmon për vazhdimësinë e mënyrës së krijimit dhe të stilit të autorit, për realizmin e tij, për rikrijimin e ambienteve plot ngjyrë dhe të tipave me individualitet të theksuar. Freskia e materialit jetësor, e thurjes së veprës, e problemit që do të zgjidhë dhe, së bashku me këto, mënyra origjinale e kapjes së subjektit, e bëjnë romanin me vlera ideoartistike dhe tërheqës në të lexuar. Kjo vepër është e arrirë për qëllimin që ka, ngjarjet vijnë të ngjeshura, romani ka ritëm; episodet, ngjarjet, detajet i nënshtrohen një qëllimi kryesor. Në këtë vepër ndihet përparimi i autorit në punë të mjeshtërisë, të ndërtimit kompozicional.

Problemi që shtron për zgjidhje Dritëro Agolli në këtë vepër nuk është i ri dhe as i patrajtuar. Autori ka ditur të lidhë problemin e madh të luftës me brengën e një fshatari, i cili ka shumë “arsye” shoqërore dhe vetjake të mos dalë dot aq lehtë nga qorrrokaku i zakonit të gjakmarrjes. Vërtetësia, dialogu, natyrshmëria e të treguarit, kompozicioni i harmonishëm i veprës e bëjnë atë të përçojë më mirë idenë. Romani ka një gjetje të veçantë: Mato Gruda zbulon një top gjerman, të mbetur pas kapitullimit të Italisë; e merr atë dhe e fsheh për të goditur hasmin e tij, plakun Mere, shtëpinë e Fizëve. Politikisht Mato Gruda është i tëri me luftën, me Partinë, po në qëndrimet e tij shoqërore-morale ka mbeturina të ndjeshme. Procesi i luftës, ngjarjet që rrjedhin në sy të tij, vrasja nga armiq të e shokut të ngushtë komunist Murat Shtaga, ngjarjet pas shtënies me top në shtëpinë e Fizëve (një goditje e pasuksesshme) ku del qartë se çdo zhvendosje e vëmendjes nga Lufta sillte dëm – këto përcaktojnë edhe kthesën e Mato Grudës, i cili më në fund, e drejton grykën e topit kundër nazistëve gjermanë dhe krisma e topit të tij bashkohet me breshërinë partizane.

Tërë marrëdhëniet e Mato Grudës me familjes, me të shoqen, një grua e mençur dhe me ndjenja delikate, me hallën, që e shtyn në gjakmarrje dhe nuk del dot nga këto paragjykime, me të birin, i cili i zë vendin pranë topit, me ushtarin italian që punon në shtëpi të tij pas kapitullimit dhe më pas del partizan etj., janë dhënë me realizëm e me ngrohtësi. Invencioni i autorit në këtë vepër (topi i fshehur dhe peripecitë me të) është një kyç artistik për ta dhënë idenë dhe këtë përmbajtje në një mënyrë të re dhe të këndshme, përmes një fakti real që kthehet edhe në një simbol jetësor. Në vepër del ndikimi i luftës edhe në ambiente të tilla si në familjen e Fizëve, ku fillojnë të kthjellohen e të kërkojnë shkaputje nga kthetrat e plakut Mere, një nga një më të rinjtë e pastaj edhe më të rriturit. Nëpërmjet situatave dramatike, duke vënë nderin mbi gjithçka, ata vendosin në çastet më përcaktuese të marrin anën e revolucionit.

2.1.1. Analiza e personazheve

Personazhet e librave të Dritëro Agollit janë thellësisht shqiptarë. Më poshtë do t'i analizojmë disa nga personazhet e këtij romani.

Mato Gruda - Kryepersonazhi i këtij romani: Një njeri që fliste me gjithë qeniet e gjalla: me qenin e me lopën, me kaun e me mushkën, me barin e me lisat. Nuk mund të therte dot as një qengj, se i vinte keq. Një njeri me shpirt aq të dhembshur, kishte gjuajtur shtëpinë e Fizëve me top. Pas gjëmimit, kur zbardhëllonte, rrinte në dritare dhe shikonte nëse në një shtëpi tjetër kishte hyrë vdekja. Kur pa që topi nuk kishte qëlluar, në fillim ai pa një gëzim të çastit që shtëpia jetonte dhe njerëzit nuk ishin lënduar. Pastaj atë e pushtoi përsëri dëshpërimi. Për Mato Grudën, të shtënat pa dobi të asaj nate, ishin një humbje e madhe. Njeriu me topin e vjedhur, i jeton ditët e tij me urrejtjen ndaj fisit të Fizëve.

Mato Gruda njihej si një shpërfillës i ngjarjeve të mëdha kombëtare. Ai i qëndron fiksimit të tij për të shlyer hakmarrjen, e cila peshonte prej kohësh e ku në të hedhin valle hijet e të vdekurve të tij.

Kur Mato gjendet ballë ballafaqimeve në sheshin e fshatit të tij, ku hetohej se cili ishte ai që ka gjuajtur me top te shtëpia e Fizëve, Mato pushtohej nga ndjenja e sikletit dhe e turpit. Pra, ai i vuri shokët e tij partizanë para akuzës se janë ata që kanë gjuajtur me top. Mato mundohet të thotë të vërtetën në mes të fshatit, por prapë hesht.

Nga kjo kuptojmë se fshehja dhe heshtja e tij, në një farë mënyre është një akt frikacak i Matos. Dhe si të gjithë frikacakët që kanë në dorë fuqinë e marrëzisë së vdekjes mbi të tjerët, personazhi i Mato Grudës pluskon në këto konflikte të brendshme të hidhura sa me aspekte humane tek ato ngushtësisht personale, të mbajtura në tension nga ankthi, frika dhe dëshira.

Pas zemërimit të tij, pasi ia kishin vrarë mikun e tij të ngushtë, Murat Shtagën, Mato lë anash interesin e tij personal para interesave të larta kombëtare dhe u bashkëngjitet partizanëve. Mato bashkë me djalin dhe gruan e tij e tërheqin zvarrë topin, deri te vendi ku partizanët i kishin zënë pritën gjermanëve.

Plaku Mere Fizi: (Një plak i gjatë me një fytyrë të hollë, me një shkop në dorë. Vetulla të bardha, që i rrinin mbi sy si dy kërpudha. Flokë të bardhë dhe që i dukeshin sikur të gjitha qimet i ishin bashkuar dhe kishin formuar një si ai myshku i mureve të lagura, veçse ngjyra e tyre nuk ishte e gjelbër si e myshkut, por e bardhë. Madje flokët dukeshin sikur, po t'i prekje pakëz, do të binin përdhe, si copëra dëbore). Plaku Mere Fizi është njëri prej figurave më të çuditshme të këtij romani. Ky personazh ngjan me një gjysh teqeje bektashiane, autoriteti i të cilit s'mund të vihet në dyshim nga ata se janë në një hierarki tjetër (baba, dervish, muhyp).

Arsyeja pse plaku Mere është personazhi më i çuditshëm në këtë roman, është se autori e përshkruan këtë plak si një njeri që ka jetuar shumë gjatë: *Njëqind a dyqind vjet vajti, ku ta dish? Thonë se i ranë dhëmbët dhe i dolën përsëri, dhe i ranë përsëri ata që i kishin dalë dhe i dolën përsëri të tjerët. Tregojnë se plaku Mere njëherë kishte vdekur e pastaj ishte ngjallur. Ai vdiq. Të afërmit e tij u mblodhën, e qanë, e mbështollën me qefin, e vunë në tabut dhe e morën për ta shtënë në varr. Në mes të rrugës që nga tabuti u dëgjua një zë...*

Plaku Mere nuk mund të jetë më një partiak absolut i familjes së madhe katërbrezash të Fizëve, sepse rinia mendon ndryshe. Lëkundja e autoritetit të tij në familje, në një farë mënyre, përbën shkelje në një tabu. Kjo ndodhi rëndom në Luftën Antifashiste, e cila krijoi një moral të ri të punëve.

Murat Shtaga – *miku i ngushtë i Mato Grudës:* (Murati merrej me komunizëm dhe i kishte lënë anash të gjitha interesat personale, ai ishte një njeri i Lëvizjes Çlirimtare, propagandist i drejtësisë dhe pastërtisë). Matos i pëlqente, se Murati ishte njeri i urtë e zemërbardhë. Të dy ishin ortakë të mirë dhe kurrë nuk kishin këmbyer ndonjë fjalë të keqe. Por, Mato Gruda kishte vënë re te shoku i tij, kohët e fundit, një gjë të papëlqyer. Murati, megjithëse ishte në hasmëri me Fizët, kishte filluar të hynte e të dilte në shtëpinë e tyre. Ai donte që edhe Fizët t'i hidhte nga ana e partizanëve, siç kishte bërë me Maton.

Murati gjithmonë mendohej t'i bindte fshatarët që ata kishin vetëm një armik. Okupatorin e kemi armik!

Gjithë puna e Muratit për të bashkuar fshatin dhe për ta bindur atë në drejtësinë partizane, ishte rrëzuar, pasi Mato Gruda kishte qëlluar me top shtëpinë e Fizëve. Këtë faj atij ia kishte vënë Tosun Baçi.

Augusto – *ushtar italian, të cilin Mato e strehon dhe e thërret atë Agush:* (Djalë i gjatë, flokë gështenje dhe fare të drejtë. Bishttrinjt e vetullave të hollë, si të vajzave dhe nuk i vëreheshin mbi sy si bashkëfshatarëve të Mato Grudës). Që me vështirimin e parë Mato Gruda e kishte vënë re se Augustoja ishte një djalë i pashëm, veç asaj iu duk i urtë dhe i sjellshëm. Ai gjithashtu dinte edhe pak shqip.

Prej Augustos, Mato mësohet se si të përdorë topin. Italiani me durimin e një ustai të argasur, ai e mëson Mato Grudën se si të përdorte topin, ai në fillim i shpjegonte pjesët që përbënin topin, pastaj hynte në hollësira të tjera.

Italianin e habiste durimi i Mato Grudës për të mësuar gjithçka që kishte të bënte me topin.

Zara – *gruaja e Mato Grudës:* (Zara në këtë roman paraqitet si një grua e gjatë, me këmbë të drejta e të bukura. Çuditërisht gjithë linjat e trupit të saj ishin të holla e të hijshme, sikur të mos ishte një shtëpiake e thjeshtë, por një femër qyteti e rritur mirë). Ky personazh kishte shpirt të butë e të brishtë. Matos kjo gjë nuk i pëlqente dhe çuditej se pse vallë, Zara të ishte aq e butë, pasi prindërit e saj kanë qenë njerëz të ashpër.

Zara i bënte presion Matos, duke i thënë se pse nuk del partizan si shokët, por merret me një top të vjetër, dhe me një italian të ngordhur. Në të vërtetë ajo kishte frikë që i shoqi të shkonte partizan, pasi linte në shtëpi dy fëmijë të vegjël. Por këtë e bënte për t'ia larguar mendjen nga topi, sepse po të mos ishte ky top, ajo nuk do ta nxiste Maton të shkonte partizan.

Hallë Esmaja – *halla e Mato Grudës:* (Kishte flokë të zinj si pendë korbi, pa asnjë thinjë, megjithëse ishte tetëdhjetë e ca vjeç). Hallë Esmaja mezi e kishte rritur Maton, që kur Fizët ia groposën babanë, nënën, xhaxhallarët, vëllanë.

Hallë Esmaja e kishte mendjen vetëm te hakmarrja ndaj Fizëve. Shpesh i thoshte Matos: “Djalë, tani duhet përvëluar Fizët, siç na kanë përvëluar!”

Tosun Baçi: (Njeri i imët me mustaqe të verdha e të rralla). Ishte në anën e ballistëve, dhe ky ua hedh fajin partizanëve, atëherë kur Mato Gruda kishte shtënë me top shtëpinë e Fizëve. Ai

veçanërisht ia hedh fajin Murat Shtagës, pasi ai mundohet t'i bënte fshatarët për vete dhe t'i hidhte nga ana e partizanëve, prandaj Muratin e kishte edhe kundërshtar, sepse ky mundohet që fshatarët të bashkohen me ballistët.

2.1.2. Ngjarja

Tema në këtë roman ka të bëjë me luftën partizane. Pas betejës së humbur, ushtarët italianë braktisën gjithë armatimet.

Mato Gruda që ishte futur në grykën e shpellës, e mori me mend se ushtarët italianë do të ishin sprapsur përtej kodrës. Pas kësaj Mato rrugës për në shtëpi e sheh një top dhe një ushtar të vdekur, të cilit ia merr armën. Mato gjithashtu merr edhe topin e braktisur nga ushtria italiane, të cilin top ai e ruan për hakmarrje. Pra, në qendër të vëmendjes në këtë roman është hakmarrja e kryepersonazhit Mato Gruda, i cili është në “gjak” me fisin e Fizëve.

Mato Gruda jetonte në fshatin Arun, i cili ishte nga fshatrat më të çuditshëm të krahinës. Ky fshat përbëhej prej pesë fisesh: Fizëve, Shtagëve, Marukëve, Pinxhove dhe Grudëve. Mes Pinxhove dhe Larukëve kishte një hasmëri të vjetër. Por, hasmëria më e madhe në fshat ishte mes Fizëve, Grudëve dhe Shtagëve. Të dy fiset: Grudët dhe Shtagët ishin kundër Fizëve. Kësisoj, fshati Arun, i përbërë prej pesë fisesh dhe nëntëdhjetë e nëntë shtëpish, jetonte me plot trazira.

Mato Gruda jetonte me gruan e tij Zarën (një grua me shpirt të butë dhe të brishtë), dy djemtë: Ziguri, i cili kishte dymbëdhjetë vjet (edhe pse ishte i ri, ai kishte një trup të gjatë dhe fytyrë burrërore dhe ishte një nga ata djemtë më të bukur të fshatit) dhe djali i vogël Sadiku. Me Maton jetonte edhe hallë Esmaja, megjithëse ishte tetëdhjetë e ca vjeç kishte flokë të zeza si pendë korbi, pa asnjë thinjë. Hallë Esmaja mezi e kishte rritur Mato Grudën, që kur Fizët ia groposën babain, nënën, xhaxhallarët, vëllain.

Mato Gruda kishte një zakon që fliste me vete. Kur fliste me vete, të tjerët heshtnin. Gjersa Mato me gruan dhe të birin po çonin topin për në shtëpi, ata kaluan edhe përreth shtëpisë së Fizëve, ishte mesi i natës, në një dritare të vogël te shtëpia e Fizëve ndriste një dritë e zbehtë. Mato Gruda fliste:

- Jeton plaku Mere Fizja, o biri im Zigur jeton! Gjithnjë ndezur e ka mbajtur natën kandilin. Njëqind a dyqind vjet vajti, ku ta dish? Nuk gjen njeri që ta dijë ç'mban

rrëza e Kokallës dhe ç'lag lumi Krak. Dhe në brez plaku Mere ka të varur çelësat e kovçekëve e çelësat e dollapëve e çelësat e qilarëve. Dhe rri shtrirë plaku Mere dhe rrallë ngrihet ecën nëpër oda me duar pas e me tespie pas. Shumë djallëzi ka numëruar plaku Mere me ato tespie, që janë aq të vjetra sa edhe rruazat e kërbishit të tij...³⁵

Kështu, Mato vazhdon të tregojë se çfarë thonë fshatarët për plakun Mere:

- Tregojnë se plaku Mere njëherit kishte vdekur e pastaj ishte ngjallur. Njerëzit betohen se kjo që rrëfëhet në fshatin Arun, nuk është përrallë, por e vërtetë si nata. Ai vdiq. Të afërmit e tij u mblodhën, e qanë, e mbështollën në qefin, e vunë në tabut dhe e morën për ta shpënë në varre. Binte dëborë dhe ishte ftohtë. Në mes të rrugës që nga tabuti u dëgjua një zë.

Allah belaversën! Ç'është ky kiamet e kjo e ftohtë kaq me llahtari! Allah, largoje prej meje Shimbër Jezit Shimbërllarin.

Ata që e mbanin, kur e dëgjuan zërin e të vdekurit, u llahtarisën, e lëshuan dhe ia dhanë vrapit. Vetëm xherahu i fshatit, Xheladin Durballia, që mbante një gunë të madhe, nuk lëvizi vendit.³⁶

Mato vazhdoi të tregonte këtë ngjarje: Xheladini e kishte marrë plakun Mere, e kishte shpierë deri te shtëpia e tij, kështu njerëzit e shtëpisë ishin zhdukur dhe kishin mbetur vetëm pleqtë, duke kujtuar se gjyshi ishte bërë lugat. Pastaj, plaku Mere filloi të numëronte se kush kishte shkuar për ngushëllime dhe kush nuk kishte shkuar.

Fshatarët me këtë ndodhi ngritën edhe një këngë për plakun Mere:

Ty, mor plaku Mere,
në tabut të vunë,
të xhumanë e zezë
në varre të shpunë

Po ti seç u ngrite,
thirre nga tabuti,

³⁵ Agolli, D., *"Njeriu me top"*, Tiranë, 2000, fq. 32.

³⁶ Agolli, D., *"Njeriu me top"*, Tiranë, 2000, fq. 33.

gjilpëra-gjilpëra
ç'na u bë vuxhuti

Në tabut të lanë,
këmbët dhe, s'u zunë,
Xheladin xherahu,
të futi në gunë

Xheladin xherahu,
më t'u thaftë dora,
s'e le plakun Mere
ta hante dëbora.

Xherah Xheladini,
Xheladin xherahu
ç'e solle lugatin
më t'u thaftë krahu³⁷

Nga ky rrëfim i Mato Grudës, tani do të bëjmë një sqarim se si fisi i Fizëve ra në hasmëri me fisin e Grudëve:

Duda, stërmbesa e Mere Fizit, vajza e bukur e Fizëve, ra në dashuri me Ramizin (djalë i pashëm dhe merrej me libra, i cili vetë kishte mësuar të lexonte dhe të shkruante, gjithë letrat që vinin e dilnin në fshatin Arun, ai i lexonte dhe i shkruante), vëllain e babait të Mato Grudës. Plaku Mere Fizi nuk e donte këtë njeri, thoshte se atij i kishte hyrë në bark shejtan Mulahimi dhe me ndihmën e shpirtit të lig i zgjidhte edhe mendimet që shkruheshin nëpër letra. Ramizi e kërkoi vajzën, po nuk ia dhanë. Atëherë ai në një natë të errët u takua me të, e mori dhe iku nga fshati Arun. Stërnipërit e plakut Mere dy vjet u vërtitën, por nuk e gjetën as Dudën, as Ramizin. Gjersa ata dy kërkoheshin, shtëpia e Fizëve me shtëpinë e Grudëve kishte rënë në hasmëri. Katër stërnipërit e plakut Mere i zunë pritën Sulës, vëllait të dytë të babait të Mato Grudës, dhe e vranë. Kjo ishte e shtëna e parë në mes të dy fiseve në fshatin Arun. Më vonë u dëgjuan edhe të shtëna të tjera më të rrepta.

³⁷ Agolli, D., *"Njeriu me top"*, Tiranë, 2000, fq. 34.

Një natë kur po binte shi, Mato Gruda doli nga shtëpia shkoi në plevicë (aty ku e kishte fshehur topin të cilin e kishin sjellë gjer në shtëpi me gruan dhe të birin), që të shikonte mos pikon ndonjë pikë shiu dhe do t'ia ndryshkë topin. Sipas zakonit Mato Gruda filloi të fliste, por kësaj radhe me topin. Kështu, ai iu rrëfye topit dhe i tregoi se si Fizët ia dogjën shtëpinë:

- Shtëpia jonë atë natë flinte. Unë me gjyshen e hallë Esmanë kishim shkuar mysafirë te dajallarët. Kam qenë i vogël fare, por të gjithë këto m'i kanë treguar. Fizët zbritën nëpër koriye të ngarkuar me shakuj të mbuluar plot. E ç'kishte në ato shakuj? Kishte vajguri. Erdhën vjedhurazi-vjedhurazi dhe, kur të gjithë flinin, i hodhën shakujt me vajguri në podrume të shtëpisë. Pastaj... ç'të tregoj... Shtëpia humbi në mes të flakës. Mes kësaj lemerie vdiq babai im, Ziguri- djali im i madh mban emrin e plakut, rahmet pastë; vdiq Sadiku- djali im i vogël mban emrin e xhaxhait, rahmet pastë; vdiq Zeneli, vëllai im, rahmet pastë; vdiq motra ime, Ganimeti, rahmet pastë!... Edhe unë do të digjesha, edhe hallë Esmaja do të digjej, por nuk u ndodhëm në shtëpi. Dajallarët e mi vranë nga dy nga Fizët. Por Fizët i shuan edhe dajallarët, se kanë qenë shumë të djallëzuar dhe shumë finokë. Pleqtë e fshatit e panë që zjarri u zgjerua pa masë, e pleqësuan punën dhe e shuan flakën. Fizët donin të më vritnin edhe mua që të vogël, që të mos nxirrja telash kur të rritesha, por nuk më vranë.³⁸

Mato Gruda po i fliste topit sikur të ishte një njeri.

Pas kapitullimit të Italisë fashiste, Mato Gruda strehon një ushtar italian, të cilin do ta mbanin në shtëpi që t'iu ndihmojë dhe gjithashtu ta fshehte nga gjermanët. Italiani quhej Augusto, të cilin Mato Gruda e quajti Agush. Augustoja dinte pak shqip, ai i kishte flokët ngjyrë gështenje dhe fare të drejtë, bishtminjtë e vetullave i kishte të hollë. Me vështtrimin e parë Mato Gruda e kishte vënë re se Augustoja ishte djalë i pashëm, dhe veç asaj iu duk i urtë e i sjellshëm. Mato në mendjen e tij kishte një plan dhe plani i tij ishte që prej italianit të mësohet ta përdorë topin. Dhe kështu ndodhi, kur Augustoja dhe Mato Gruda fillonin mësimin e artilerisë, ata e mbyllnin me lloz derën e plevicës. Italiani me durimin e një ushtari të argasur, së pari i shpjegonte Mato Grudës pjesët që përbënin topin: tytën, shtratin, rrotat, mekanizmin e shkrepjes, mekanizmin e shënimit, pastaj hynte edhe në hollësira të tjera. Gjersa Mato Gruda dhe italianin po bënin manovra, Mato i tha italianit:

³⁸ Agolli, D., "Njeriu me top", Tiranë, 2000, fq. 53.

- Ta zëmë, për të goditur atë shtëpinë atje në grykë të përroit, sa gradë duhet ta shpiejmë këndin.

Italiani hapi derën e plevicës dhe vështroi nga mali i Kokallës. Ishte shtëpia e Fizëve, e cila zbardhte në këmbë të malit.

Italiani iu përgjigj – Shtëpia, për shembull, 30 gradë... Italiani mendonte se Mato do ta përdorte topin për luftë dhe do të bëhej hero nacional.³⁹

Një natë Mato Gruda shkoi te plevica, kur të gjithë ishin duke fjetur, u ul në trungun e thatë dhe drodhi një cigare dhe filloi të humbte në kujtimet e hidhura, se si Fizët ia dogjën atij gjithçka që pati. Matoja e tërhoqi topin, e ktheu në drejtim të derës së plevicës. Mato Gruda e vështroi edhe një herë shtëpinë e Fizëve dhe e tereziti tytën e topit. Këndin e gradimit e la aq sa i kishte thënë italiani, mori edhe gjylet. Me dorë në mekanizmin e shkrepjes, tha me zë të lartë:

- Plaku Mere, Haufmani (emrin e topit) do të ta shuajë me atë presionin e tij. Dëgjoni, o Fizë! Edhe një dekok dhe fluturoni në atë botë, se shumë të liga i keni sjellë kësaj shtëpie!⁴⁰

Kështu, vazhdon dhe i numëron të vdekurit, të cilët ia kishin vrarë Fizët. Si e tërheq litarin e mekanizmit të shkrepjes dhe plevica u tund dhe veshët iu zunë nga gjëmimi. Ai gjuajti edhe një herë. Ai mendoi se i kishte qëlluar Fizët. Por, në mëngjes ai e merr vesh që nuk kishte bërë gjë.

Në fillim ai këtë dëshpërim nuk e ndjeu, pasi qenia e tij ishte ende e mpirë nga narkoza e hakmarrjes. Por, Mato Grudës kur i del pija në mëngjes, ai bie në një dëshpërim të thellë. Ai e ndien veten pa asnjë kokërr energjie, pa asnjë mendim, pa asnjë pasion. Atë e pushtojnë mërzia dhe indiferentizmi.

Ishte kohë lufte. Matoja i kompleksuar nga hakmarrja, nuk ishte në gjendje të bëjë ndasinë politike. Kur ai gjuan shtëpinë e Fizëve, nuk mundi ta godasë, ai zhgënjehet shumë. Por, kur Mato Gruda ndodhet përballë ballafaqimeve në sheshin e fshatit midis Ballit dhe partizanëve, të cilët po hetonin se cili ka goditur me top shtëpinë e Fizëve, Mato pushtohet nga një ndjenjë sikleti e turpi. Ballisti Tosun Baçi mundohet t’ia hedhë fajin Murat Shtagës (shoku i ngushtë i Mato Grudës, i cili ishte partizan në Lëvizjen Nacional-çlirimtare). Hakmarrja e Mato Grudës

³⁹ Agolli, D., *“Njeriu me top”*, Tiranë, 2000, fq. 91.

⁴⁰ Agolli, D., *“Njeriu me top”*, Tiranë, 2000, fq. 146.

i kishte vënë miqtë e tij partizanë para akuzës se janë ata që kanë shtënë me top, si njerëz që bëjnë krime, gjuajnë shtëpitë e fshatit të tyre e duan gjak dhe derdhje gjaku. Mato pasi e sheh që ballistët po i akuzojnë partizanët, e në veçanti Murat Shtagën, shokun e tij besnik, të cilin e donte, mendohej t'i tregonte të vërtetën fshatit. Ai mendonte mes vete: Tek e fundit, të mbijetuarit e hasmit kanë të drejtë të dinë se kush ka qëlluar mbi fisin e tyre.

Fshehja dhe heshtja është një akt frikacak i Matos, i cili kërkon të dalë pa lagur, madje ky akt orvatet të interpretohet sikur është bërë nga partizanët. Po ky akt është gjithashtu prishje e normave të hakmarrjes apo shkelje e të drejtës për të ditur se nga vjen plumbi. Matoja heshte vazhdimisht, nganjëherë i vinte ndonjë mendim që të hidhte të vërtetën në shesh, por ai nuk guxonte, pasi mendonte që me atë top të qëllonte prapë shtëpinë e Fizëve.

Fshati nuk ishte aspak i qetë, flitej se gjermanët do të pushtonin fshatin edhe një javë. Por, fshatarët nuk i linte të qetë gjëmimi i asaj nate

Si të gjithë fshatarët që kanë në dorë fuqinë e marrëzisë së vdekjes mbi të tjerët, personazhi i Mato Grudës pluskon në këto konflikte të brendshme të lidhura sa me aspekte më humane tek ato ngushtësisht personale, të mbajtura në tension nga ankthi, frika dhe dëshira.

Kaloi një javë, por gjermanët ende nuk kishin mbërritur në fshat, ata u vonuan. Në fshat ende flitej për topin. Një prej netëve në portën e Mato Grudës trokiti dikush, ishte stërnipi i plakut Mere Fizit, ai ishte bashkuar me radhën e partizanëve, dhe e lajmëroi të zotin e shtëpisë se atë e kishte dërguar Murat Shtaga që ta lajmërojë se gjermanët ishin afruar. Ata duhet t'i mblidhnin gjërat dhe të niseshin për te shpella. Për çudi, Mato Grudës iu kishin ngatërruar të gjitha punët, hallë Esmaja ishte shumë e sëmurë, ajo nuk mundte as të lëvizte; topin e kishte të fshehur te kolibja e qenit të tij; Lara (lopa që mbanin) ishte në prag të lindte viçin e saj. Edhe pse ishin në gjendje shumë kritike, ato i mblodhën gjërat dhe u nisën për në shpellë. Aty ishin mbledhur të gjitha fiset e fshatit. Mato Grudës nuk i kishte rënë ndonjëherë në mend se të gjitha fiset e fshatit do të bashkoheshin në atë shpellë. Pasi u vendosën në shpellë, Mato, i biri dhe gruaja shkuan përsëri që t'i marrin edhe disa gjëra që kishin lënë.

Gjermanët u vonuan, fshatarët ende nuk merrnin asnjë lajm për ta.

Kur Mato, Ziguri dhe Zaka ishin tek shtëpia e tyre, deri sa ishin duke mbushur thesin me roshnica, u dëgjuan nja dy të shtëna pushkësh. Mato Gruda ngriu. Ato nuk e dinin se si do të vejë puna. Në atë çast u dëgjua një gjëzim i tmerrshëm. Njëherit, ato menduan të iknin për në shpellë, por andej qëllonin gjermanët. Mato i tha Zigurit dhe Zarës të fshihen në bodrum

dhe i tha të mos lëviznin deri sa të kthehej ai. Mato Gruda filloi të vraponte, te rrapi i madh, në mes të sheshit të xhamisë, pa një grumbull me burra e plaka. Ata ishin fshatarët që nuk kishin arritur të iknin në shpellë. Rreth grumbullit qëndronin njerëz të armatosur, me feste të bardha. Mato ndaloi aty, njëri nga ballistët i tha të futet në grumbullin e burrave. Ai u drodh si purtekë, kur pa në shesh para njerëzve një trup të shtrirë, të gjakosur e të sakatuar. Disa hapa larg trupit qëndronte një gjerman dhe pas tij një burrë i hollë me mustaqe. Ai ishte Tosun Baçi. Pasi Mato pyeti se cilin e kanë vrarë. Dikush pëshpëriti që e kishin vrarë Murat Shtagën. Matos iu morën mendtë dhe gati sa u rrëzua. Pasi mori vesh se si e kishin vrarë Muratin, Mato qëndronte i përhumur mes grumbullit të njerëzve të përzier me gjermanët dhe ballistët.

Tosun Baçi i detyronte fshatarët që ta kapërcenin trupin e vdekur, me qëllim që të dijë se a e kanë dashur fshatarët Murat Shtagën apo jo. Kur iu kërkua ta kapërcente kufomën stërnipit të parë të plakut Mere Fizi. Ai iu afrua trupit, pa thënë asnjë fjalë u ul në gjunj. Tosun Baçi i thoshte atij që t'ia përplaste kokën, por Fahremedinaliu iu afrua me gjunj trupit, pastaj ia vuri njërin krah nën sqetull dhe e ngriti Muratin, duke e vënë ndenjura. E afroi nga vetja dhe e përqafoi, dhe i tha:

- Më fal, o Murat Shtaga! Unë gjer tani kam qenë i verbër. Kam qenë i vdekur. Tani jam i gjallë. Edhe ti je i gjallë. Një i gjallë flet me një të gjallë!

Pastaj ia ktheu kokën Muratit nga ana e gjermanit dhe e Tosun Baçit dhe tha:

- Ti je i gjallë, ndaj këta ta kanë frikën! Më lejo t'i pështyj një herë!⁴¹

Kështu, Fahremedinaliu, hodhi një pështymë drejt gjermanit dhe Tosun Baçit. Në atë kohë gjermani e vrau atë. Turma u përhap. Mato Gruda u lëshua tatëpjetë sheshit dhe hyri në rrugicën mes kumbullave të zhveshura e mes ferrave. Ai vraponte sa i hanin këmbët. Kurrë në jetën e tij nuk kishte provuar çaste të tilla kaq të ashpra, kaq të shqetësuar, kaq tronditëse. Mato vrapoi drejt shtëpisë së tij. Ai i pa gjermanët me makina, të ngarkuara me municion, duke tërhequr pas topa të mëdhenj. Mato prapë nisi vrapin.

Hyri në bodrum dhe mezi u qetësua pak. Zara dhe Ziguri ishin të shqetësuar nga gjendja e tij, fytyra e tij kishte marrë ngjyrën e dheut. Të tre dolën nga bodrumi dhe shkuan nga ana e prapme e kolibes, Mato ngriti kokën dhe drejtoi sytë nga faqja e malit. Makinat vazhdonin të

⁴¹ Agolli, D., "Njeriu me top", Tiranë, 2000, fq. 280.

ngjiteshin. Ai po nxirrte topin, gruaja e kuptoi se kishte ardhur koha që ai të zgjohej, për gruan tani ai top kishte krejt kuptim tjetër. Ata filluan ta tërhiqnin topin deri sa shkuan në mes dy shkëmbinjve.

Ishte hera e dytë, Mato i zëmëruar nga vrasja e shokut të tij Murat Shtagës, lë anash interesin personal para interesave të larta kombëtare (ashtu siç gjithmonë Murat Shtaga mundohej t'ua mbushte mendjen fshatarëve) dhe iu bashkua partizanëve. Ata tërhoqën zvarrë topin deri te vendi ku partizanët kishin zënë pritën gjermanëve.

Mato Gruda vështroi makinat. Pastaj u përkul mbi top dhe e ktheu tytën disa gradë nga ana e majtë. Ziguri e ndiqte me sy, por nuk e kuptoi se ç'po bënte. Ai mori shenjë dhe e tërhoqi konxhën e mekanizmit të shkrepjes. Pas një çasti larg mbi çatinë e shtëpisë së Fizëve u ngrit një flakë e përzier me tym. Më vonë ai e drejtoi tytën nga makinat gjermane, mori shenjë dhe qëllloi. Makina kishte marrë zjarr. Ata përsëri gjuajtën. Përsëri atje te makinat filloi paniku dhe rrëmuja, ushtarët gjermanë vraponin dhe zinin pozicion nëpër shkurret e malit dhe nuk dinin nga vinin këto predha. Mato Gruda dhe Ziguri nuk ndaleshin. Mato e dinte se topi do të zbulohet. Në atë kohë sa po gjuanin, vërshëlleu një predhë dhe plasi para tytës së topit. Mato Gruda ndjeu diçka në gjoks. Fytyra e Matos kishte marrë ngjyrën e zbehtë, ai ishte shtrirë nën dëllinjën e kaltër dhe gjaku i rridhte nga gjoksi.

- Zigur! - tha Mato Gruda – Unë nuk mbeta borxhli ndaj teje, edhe ndaj vendit... Ti më vure re si i futa gjylen? Hiqe pas llozin dhe fute gjylen... Pastaj shkrepe... Ja, atje... S'ka gjë Zigur, unë po çlodhem nën dëllinjë, ti qëllo!...

Mato Gruda vuri re se korija dhe maja e Kokallës morën ngjyrën e portokallit. Gjithçka mori ngjyrën e portokallit. Pastaj ai ndjeu një gjëxim. Ngriti kokën dhe përmes kësaj ngjyre portokalli pa Zigurin pranë topit.

- U rrit... Qëllon... – tha Mato Gruda rrëzë dy shkëmbinjve të murrme.
Balua, qeni i tij, i rrinte në bisht me kokë pranë fytyrës që po shuhej, dhe angullinte me një zë të zgjatur që i shëmbëllente vajtimin...⁴²

⁴² Agolli, D., *"Njeriu me top"*, Tiranë, 2000, fq. 297.

2.1.3. Mesazhi

Ajo që i jep vlerat e një perle midis perlave të tjera është mesazhi i qartë i këtij romani. Një mesazh shumë i fuqishëm.

Mesazhi që përcjell ky roman është bashkimi.

Jemi një popull i copëtuar dhe nga trangu origjinal mungojnë pjesë të mëdha të atdheut! Jemi njerëz që mbi të tëra, bota na njeh si vëllavrasës, pra, si ata që vriten kollaj me njëri tjetrin, duke përdorur Kanun-in për vrasje të cilat shpesh harrohen pas kohësh sepse e kanë bazën në shkaqe banale!

Kjo është arsyeja pse ky roman merr vlerë kaq të madhe.

BASHKIMI! Mesazhi që sillte atëherë romani, ka mbetur i patjetërsuar edhe sot!

2.1.4. Kritika letrare për romanin

Alen Boske:

Personazhi me kompleksitet të habitshëm

Për botimin në Francë poeti dhe kritiku i shquar francez **Alen Boske** në gazetën prestigjioze **“Quotidien”**, 5 maj 1995, shkruan:

“Njeriu me top’ nxjerr në skenë një personazh të një kompleksiteti të habitshëm. Edhe pse është një fshatar i humbur në tokat e tij shterpë, në kohën e Luftës së Dytë Botërore, Mato Gruda, ky njeri në dukje i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë mund t’i përkiste traditës herë homerike dhe herë virgjiliane. Shqetësimet e tij janë imediate, që nxjerrin në pah hakmarrjen e përjetshme ballkanike. Kujtesa e tij është e mbushur me fakte dhe me gjeste të lashta. Ai është luftarak dhe mund të thuhet se çdo luginë, çdo burim dhe çdo kodrinë i kujton grindjet, rrëmbimet dhe luftërat e tij të ashpra e të koklavitura. Punët e bujqësisë me fuqinë e tyre nuk ia imponojnë dot logjikën dhe arsyen. Ai është në gatishmëri, pasi kështu është natyra e tij. Që prej mesjetës dhe që prej kompleteve të Perandorisë Osmane asgjë s’duket të ketë ndryshuar. A e kupton Mato Gruda gjendjen në të cilën ndodhet vendi i tij? Kjo nuk është e sigurtë. Nga ana tjetër, pushtimi italian është relativisht i butë: shqiptarët këtë e njohën pa përdorur dredhira. Aspekti jashtëkohor i personazhit ka diçka të gjerë dhe të shqetësuar.

Rastësia e do që të gjejë udhës së tij një top të vjetër. Ideja e parë e tij, që iu ngulit keq, ishte që ta merrte: mund të kërcënonte armiqtë e tij të përjetshëm me një bombardim përfundimtar. Mund të mbulohej me lavdi, ashtu siç e kërkonte ambienti përreth dhe zakoni. Por, nuk mund ta përdorte dot vetëm, ndaj bëri si bëri dhe u ndihmua nga një rob italian. Nuk e kupton absurditetin e qëllimit të tij: të lidhej me armikun e huaj për të bërë zap disa komshinj të tij. Arma e bën heroin dhe nuk ka se ç'na duhet qëllimi! Ngjarjet pasojnë njëra-tjetrën dhe pas pak italianët zëvendësohen me gjermanët, metodikë dhe thellësisht mizorë. Mato Gruda do ta ndryshonte planin e vet, do ta ndryshonte edhe mentalitetin. Është çasti i sakrificave dhe i vuajtjeve pa emër. Hakmarrja i zë vendin rezistenca ndaj pushtuesit. Do të duhej vdekur për atdheun e vet, duke harruar mërinë shekullore. Askush nuk i shpëton kësaj. Kjo parabolë ka gjerësi të ndjeshme. Ajo ka zemërim dhe herë-herë një konceptim të çuditshëm lirik të fatalitetit të hidhur me absurditetin. Dritëro Agolli është një shkrimtar që nuk pranon të çlodhet...”⁴³

Ismail Kadare:

Ismail Kadare shkruan në kopertinën e botimit të parë të “Njeriut me top” nga Shtëpia botuese “Le passeur” në Francë:

“Par son écuriture á la fois charnelle, très terrienne et pleine d’humour, de finesse et de sobriété, Dritëro Agolli est une des voix les plus fortes et les plus personnelles de la littérature albansise actuelle”

Në shqip do të thotë: “Për stilin e tij të mishtë (ngjeshur), tepër tokësor dhe të mbushur plot me humor, me finesë dhe kursim, Dritëro Agolli është një nga zërat më të fortë dhe më individualë të letërsisë aktuale shqiptare”.⁴⁴

⁴³ Agolli, D., “Njeriu me top”, Tiranë, 2000, fq. 312.

⁴⁴ Agolli, D., “Njeriu me top”, Tiranë, 2000, fq. 312.

Alter-ego:

Gazeta “Le Temps” Gjenevë, Zvicër, Maj 1998

Alter-ego shqiptar i Zhono-s: “Ashtu si Kadareja, Dritëro Agolli i përket brezit të sakrificës, asaj të viteve të plumbit e terrorit. Ajo kohë vjen me dy libra që e meritojnë t’iu rikthehesh. Një roman, “Njeriu me Top”, që evokon eposin e vjetër Ballkanik. Mato Gruda, heroi, është një lloj Zorbe shqiptar i gjendur në trazirat e Luftës së Dytë Botërore. Një mbrëmje, në mes të një pylli, ai zbulon një top të stërmadh të braktisur nga trupat e mundura italiane: një armë ideale për të marrë hakun e familjes së tij duke asgjësuar një fis armik ndaj të cilit ushqen urrejtje prej brezash.

Mato ndez kështu zjarret e hakmarrjes/vendetta-s. të cilën e shohim të bëjë reprezalje mbi një Shqipëri të shpartalluar nga një luftë e dyfishtë: nga jashtë e nga brenda. Mbi këtë western tragjik, Agolli derdh jo pak sarkazëm, derisa fatkeqi Mato, shembet përtokë, viktimë qesharake e marrëzisë së vet...

Tregimet e vëllimit “Zhurmat e erërave të dikurshme”, na shpjen tek e njëjta luftë, në momentin kur pushtuesi fashist është mposhtur nga guerilasit krenarë të Vendit të Shqiptonjave. Mes dy pritave, ata u bien violinave të çakorduara, zbrazin litra me raki, thithin çibukët e gjatë, kërcejnë me dervishët, i kënaqen peizazheve shqiptare ku kodrat bëhen të buta, në vjeshtë, “sa mund t’i hash me lugë”.

Ka pak Zhono tek Agolli. Por është një Zhono i shqetësuar, i kapur mes kultit të Nderit dhe frikës ta shohë këtë luftë të degjenerojë në hakmarrje, një luftë vëllavrasëse, ndërkohë që përballen komunistë e partizanë të regjimit të shkuar. Në një Shqipëri njëherazi magjiplotë dhe djallëzore, që Dritëro Agolli e vizaton si një teatër ku luhet me hijet. Magjepsës.”⁴⁵

2.2. Romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”

Në parathënien e librit “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” shkruar nga vetë autori, shpjegon se romani i tij godet disa dukuri burokratike sipas mësimave të partisë dhe shokut Enver. Libri – rrëfen autori – është botuar pjesë – pjesë si novelë në Revistën “Hosteni”, nga

⁴⁵ <http://telegraf.al/kulture/njeriu-me-top-magjeps-gjeneven/> (qasja e fundit 10.11.2018)

kryeredaktori Niko Nikolla, ish miku i tij i cili e nxiti ta shndërronte në roman. Dritëroi pati ndikim pozitiv nxitës edhe nga lexuesit e shumtë të “Hostenit” që flisnin në superlativ për novelën. Kjo i dha guximin ta ripunojë e formësojë si roman humoristik dhe e botoi në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”. Pasi libri doli në qarkullim, pati zëra të vakët burokratësh, që e identifikonin veten me personazhet dhe e kritikonin romanin, por funksionarët më të lartë të PPSH-së e pëlqyen këtë vepër dhe kritikuesit e mbyllën gojën.⁴⁶

Me këtë libër për Zylon, që u botua në Shqipëri qysh në vitin 1972, Dritëro Agolli pasuroi letërsinë botërore me një roman satirik brilant.

Ky roman u nis në fillim si fejton, më tej si tregim, si tregim i gjatë, si novelë dhe vetëm në fund i botuar me tipologjinë e vërtetë, si roman satirik. Ky roman pasqyron një kronikë të karrierës së palavdishme të një zyrtari “në vijë”, romani është në të njëjtën kohë pasqyrë e pozitës së mjerë të vartësit të tij, Demkës, një kalemxhi i stërvitur, që pak nga pak është ndarë me talentin.

Në këtë roman na flet drejtpërdrejt personazhi i Demkës. Ngjarja është e treguar kronologjikisht, dhe lidhet me kulmin e karrierës së Zylos dhe rënien e tij nga ana profesionale. Pra, Zylo është personazhi kryesor, pasi ngjarjet përqendrohen rreth tij. Gjithashtu ngjarjet tregohen në vetën e parë.

Në romanin humoristik të D. Agollit, Zyloja dhe Demka, janë shkurtime të emrave tradicionalë “Zylyftar” dhe “Demir”.⁴⁷

Por të gjithë jemi të vetëdijshëm se kontributin më të rëndësishëm të Dritëro Agollit në prozë është sjellja para lexuesit këtë roman. Ky roman është një kronikë e karrierës së palavdishme të një zyrtari “në vijë”, romani është në të njëjtën kohë pasqyrë e pozitës së pandashme të vartësit të tij. Produkt të njëri-tjetrit, këta dy personazhe kryesorë shoku Zylo dhe Demka, japin një pasqyrë të pozitës së pandashme të intelektualit si shoku Zylo. Zylo dhe Demka, siç ndodh në të gjitha romanet apo veprat që kanë karakter humoristik, janë pasqyrë e anës qesharake dhe njëherësh dramatike të funksionimit të burokratizmit.

⁴⁶ <https://www.voal.ch/shkelqimi-dhe-renia-e-shokut-zylo-dhe-alibia-e-estetit-alfred-ucit-dritero-agolli-kunder-realizmit-socialist-nga-mexhit-prenci/?fbclid=IwAR3olrLhqDLSjbGuv2oa8UaK4IJs0ghJiM3JTUwtVAzIIWuyvW1PnNswm4> (qasja e fundit më 10.11.2018)

⁴⁷ https://sq.wikipedia.org/wiki/Shk%C3%ABlqimi_dhe_r%C3%ABnia_e_shokut_Zylo (qasja e fundit më 15.11.2018)

Sot, shteti zyrtar dhe politika janë larg nocioneve shteti i së drejtës, dhe politikë demokratike që zgjidh nyjet gordiane ekonomike e sociale të qytetarit... Fenomenologjia është studimi i strukturave të përvojës burokratike vicioze, së bashku me kushtet përkatëse të përvojës të termit zyrtar në përgjithësi. Sërish, duke u ndërlidhur me fenomenologjinë dhe funksionimin e shtetit nga polikbërja e një grupi individësh që njohjet i kanë për përfitim të interesave vetjake, lirshëm mund të vërejmë se qeverisja e tyre me shtetin nuk trajton fenomenet, por çështjet personale. Ndërkohë që flasim për fenomene zyrtarësh në kohë reale, kuptojmë hapur se Zylot dhe Demkat në të gjitha shtetet ballkanike janë ngatërruar në lidhje me inkuadrimin e mirëfilltë shtetëror. Shtetet ballkanike janë pothuaj pranë ngërçit politik, ndërsa zbatueshmëria e plotë e ligjeve vazhdon të prodhojë burokratë pambarimisht; ndërkaq, lajthitjet e ligjeve nga ana e zyrtarit shtetëror përdhos shoqërinë, qytetarin... Për të mbetur sërish skllav të fajësisë kolektive, fenomen refren, denoncuar kohë më parë nga Kafka, Kamyja deri diku edhe Dino Buxati e për t'u përshëndetur te Agolli, si një ves që karrigia ia shton zyrtarit koherent.⁴⁸

Natyrat moraliste të zyrtarëve janë të këqija: para së gjithash në kuptimin politik të fjalës së papërgjegjshme dhe në këtë kontekst: janë politikanët moralistë: të atillë që ne për fat të keq i kemi pasur nëpër pozitë udhëheqëse: është pra ajo që ne e quajmë sundimi i zyrtarëve; dhe me të vërtetë nuk bie asnjë njollë në nderin e nëpunësit tonë, kur ne këtë politikisht, parë nga prespektiva e suksesit, i nxjerrim në shesh të metat e këtij sistemi” thotë Max Veber. Për të gjitha të vërtetat që përcjell, shoku Zylo është perspektiva e një romani satirik jo të izoluar, por të mendjes së hapur dhe vetëkorrigjimit në kohë.⁴⁹

IRONIA: Tallje (për dikë a për diçka) që bëhet në mënyrë të hollë e të mbuluar, duke folur gjoja me gjithë mend; qesëndi. Ironi e fortë (therëse, keqdashëse). E kuptoj ironinë. Flet (qesh) me ironi. Godet me ironi. Por kjo e fundit del edhe me vlerën e një figure stilistike. Dhe, si e tillë, në FGJSSH shpjegohet në këtë mënyrë: let. Figurë stilistike, me anë të së cilës shkrimtari, duke u dhënë fjalëve, shprehjeve etj., një kuptim të kundërt nga ai që kanë në të vërtetë ose duke bërë sikur pranon të kundërtën e asaj që mendon, përqesh e vë në lojë dikë a diçka. Përdor ironinë. Ironi e fatit libr., përdoret kur ndodh diçka që nuk pritej e as mund të

⁴⁸ Budini, B., *“Dritëroi rrëfen aventurat e Zylos”*, gazeta: *“Shekulli”*, 17 shtator 2000, f. 23

⁴⁹ Veber, M. *“Politika si profesion”*, Shkup, 2006, f. 38-40; 75-80.

mendohej, kur vjen diçka fare e rastit dhe e pagjasë ose kur diçka gjen një zgjidhje krejt të kundërt nga ajo që pritej a që duhej.⁵⁰

Në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” gjejmë disa neologizma të krijuara me përbërje, të cilat i përkasin stilit zyrtar administrativ si: fjalëshkëmbimi, raportshkruesi, karakterdobëti, moralprishuri, mirëdashësi.⁵¹

Përshkrim i shkurtër i romanit: Në këtë roman ngjarjet fillojnë me ngritjen e shokut Zylo në detyrë dhe mbarojnë me heqjen e tij nga posti i rëndësishëm që kishte. Autori në këtë roman ka si synim ta bëjë lexuesin të qeshë, prandaj dhe vihet re përdorimi i theksuar i ironisë. Që do të thotë se autori ironizon administratën në atë kohë.

Analizë: Vepra më e bukur satirike e Dritëro Agollit dhe një ndër romanet më të goditura të këtij lloji është “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” (1973).

Ky është një roman që ngrihet kundër madhështisë së rreme e vanitetit dhe tregon, përmes shumë situatash, qëndrimesh të “heroit”, sentencash e monologjesh se sa qesharake dhe të dëmshëm janë njerëz si Zyloja që jetojnë të mbështjellë në një burokraci të përditshme dhe nuk shohin gjendjen reale, nuk kuptojnë ç’mendon në të vërtetë shoqëria për ta. Të dy personazhet që rrinë krah për krah, Zyloja dhe ndihmësi i tij, Demka, kalojnë nëpër një varg episodesh dhe, si tipa letrarë, vlejnë për të zbuluar njëri-tjetrin. Demka, njeri i zgjuar dhe me aftësi, e kupton gjithçka dhe e njeh “të zotin” (binom i njohur dhe i preferuar në prozën satirike ky i të zotit dhe i një pasuesi!), por nuk del dot nga dora e tij dhe i nënshtrohet. Ai i thotë fjalë të mençura, kupton thelbin komik të Zylos si edhe ndonjë anë të mirë që ka ai.

Zyloja si tip është një dukuri negative që e pjell burokratizmi, i cili te ne luftohet në çdo shfaqje të tij.

“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” me tërë episodet dhe situatat ka në qendër kurdoherë figurën qendrore të Zylos që demaskohet para syve tanë hap pas hapi. Zbulimi i tij nëpër situata, qëndrimi i Demkës, i Arianitit të ngrysur e të vrazhdë, po të drejtë dhe, sidomos, i kolektivit të fshatarëve etj., që qesh e tallet me marrëzitë e Zylos – këto hedhin dritë në

⁵⁰ Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, 1980, f. 729.

⁵¹ T.Osmani, M.Gero, “Mendime për gjuhën dhe stilin e Dritëro Agollit”, Gjuha jonë, 1, Tiranë, 1991

karakterin e tij dhe japin të qartë mendimin e autorit, sipas të cilit për shoqërinë tonë Zyloja është një fenomen, në thelb i huaj e negativ, që satirizohet. Ndjenja e shëndoshë e humorit popullor, e optimizmit, e gazit të çiltër e përshkojnë këtë roman.

Analiza e kompozitave, si një nga mjetet më të fuqishme të pasurimit të leksikut të shqipes, na dha mundësi të shqyrtojmë nga pikëpamja praktike se dukuritë gjuhësore janë të lidhura njëkohësisht me rrafshin e realitetit dhe të mendimit, me mënyrën se si një bashkësi gjuhësore e abstragon realitetin duke nxjerrë në pah tipare të veçanta të relievit, me mjetet që kjo bashkësi përzgjedh për të përpunuar formën e shprehjes, imazhet psikike që folësit sendërtojnë gjatë procesit të përshfaqjes së koncepteve, me përfytyrimin që kanë këta të fundit për botën që i rrethon duke “prodhuar” një shumësi shenjash të ndryshme, origjinale dhe lehtësisht të dallueshme nga njëra- tjetra. Dhe, në këtë kontekst, nuk mund të lihet pa përmendur fakti se këto shenja gjuhësore kanë formuar vargje të zgjeruara sinonimike, sikurse dhe një tërësi fushash konceptore dhe leksikore të bazuara te treguesit themelorë të reales, të përzgjedhur dhe të sintetizuar mendërisht në bazë të përceptimeve të ndryshme për të asociuar simbolikën tingullore me një përkatësi “natyrore” të përmbajtjes së fjalës. Në rastin e kompozitave, “substanca kuptimore” e lidhur me tërësinë e perceptimeve, qëndrimeve subjektive të folësve, ndjenjave dhe abstragimeve mendore, sipas mendimit tonë, është e ndryshme. Zyloja nuk është i vetëdijshëm për sëmundjen që e mundon. Ai nuk është një burokrat skematik, që shquhet që atje tej. Përkundrazi, lexuesi e mbyll librin i bindur se, po të mund të bëhej i ndërgjegjshëm për dobësinë, shokut Zylo ndoshta do t’i vinin mendtë dhe do të gjente forcë për të ndrequr veten. Prandaj ai është një figurë fatkeqe, ku bëhen bashkë mirësia e qëllimit me padijen, me humbjen e ndjenjës së realitetit, të masës për të vërtetën. Në këtë kuptim, Zyloja i shfaqet lexuesit në një pamje sa të rrezikshme, aq edhe për t’i qarë hallin. Zyloja nuk i beson faktit, por imazhit që ka në mendje, iluzionit. Përmasa e jetës në mënyrën e të menduarit të tij është zëvendësuar nga idetë dhe format. Subjektivisht Zyloja e konsideron veten në pararojë të shoqërisë, kurse objektivist e kufizon atë. Ai nuk është i vetëdijshëm për dëmin që u sjell vetes dhe të tjerëve. Beson në një meritokraci fiktive dhe kjo e bën qesharak. Këtu ndahet edhe qëndrimi emocional i autorit. Ai e përqesh, e satirizon, e vë në pozitë të vështirë personazhin e vet, por edhe i dhimbset, e justifikon disi, bile, në një farë mënyre, ka raste kur duket qartë se e merr në mbrojtje, duke mos e zhveshur nga çdo vlerë.

Situatat që kalon Zyloja i jeton me seriozitetin më të madh, kur të tjerët mezi e mbajnë të qeshurën. Duke ngatërruar forcën e ligjit, të kompetencës, të të drejtave si epror, me forcën e

argumentit, që është autoriteti më i lartë, ai i vesh vetes attribute të pamërituara, beson verbërisht në forcën çudibërëse të urdhrit, të fjalës. Duke imituar modelin që ka zgjedhur si shpresë për “nëpunësin në ngjitje”, ai shmanget nga vetja. Burokrat i çuditshëm, në të shumtën e herës i dehur nga një realitet që nuk ekziston, i mërguar nga jeta e vërtetë, megjithatë, herë-herë Zyloja thotë disa të vërteta lakonike dhe të befta, që ai i quan “ese”. Në këto raste është shumë e vështirë të përdoret për të emërtimi burokrat. Madje lexuesi mund të mendojë njësoj si Sanço Pança për “ustain” e vet të dehur nga fantazia e sëmure Don Kishoti: “Sa mirë do të ishte të mos e pushtonte ajo sëmundje e mallkuar”, ajo marramendje, ajo dehje që vjen nga iluzionet, ai dyzim dhe ajo shpërfillje e realitetit.

Në gazetën “Le Monde” theksohet: Agolli paraqet në katër pjesë dhe afro 20 kapituj, jetën dhe detyrat e një prej aparatçikëve me pak të njohur në botë. Një kuriozitet ngazëllyes.

2.2.1. Analiza e personazheve

Shoku Zylo: është kryepersonazhi në këtë roman. Ai është drejtor i sektorit të librit në sektorin e madh të kulturës. Shoku Zylo vendoset në këtë post në fillim të librit. Që në këtë moment vëmë re se ai merr në dorë frerët e punës, por gjithmonë vë në dukje mangësitë e drejtorit të mëparshëm. Në të vërtetë Zylo Kamberi është një figurë tragjedi – komike. Veprimet e tij të bëjnë të qeshësh, po aq sa edhe të ndjesh keqardhje. Arroganca e tij është e heshtur, por edhe është një burokrat i qetë dhe i heshtur. Veprimet e tij përherë janë me qëllim të mbarë, por që gjithmonë e çojnë në gabime trashanike dhe qesharake. Ai është një figurë fatkeqe. Ai na shfaqet në një pamje sa të rrezikshme, aq edhe për t’i qarë hallin.

Zylo mendon se idetë dhe punët e tij janë të një vlere të madhërishtme për kombin dhe kulturën, por që të gjithë të tjerët mendojnë ndryshe dhe posti i Zylos e bën atë të pakundërshtueshëm. Ai i jep attribute të pamërituara vetës dhe punës së tij. Shoku Zylo mendon se hierarkia shtetërore është edhe hierarki meritash, por që Zylo i ka meritat e tij, por jo në nivelin të cilin ai i imagjinon. Veprimet e tij që i bën, na bëjnë të qeshim, e herë ndjejmë një keqardhje për shkak të paditursisë së Zylos.

Zylo jeton dhe i percepton gjërat sipas imagjinatës së tij, dhe jo sipas fakteve të së vërtetës. Ky pra është personazhi i shokut Zylo, një personazh që sa të vjen keq prej tij, por të bën për të qeshur i cili është rezultat i pushtetit të kohës.

Zyloja nuk është një burokrat bujëmadh, i zhurmshëm. Arroganca e tij është e hedhur, kurse veprimet e tij përherë priren nga qëllime të mbara, por çojnë në gabime trashanike. Zyloja është një figurë fatkeqe, ku bëhen bashkë mirësia e qëllimit me humbjen e ndjenjës së realitetit, të masës për të vërtetën.

Ndryshe nga shumë burokratë të tjerë skematikë që kishin përmbytur jo vetëm letërsinë shqipe, por edhe publicistikën, Zyloja është një burokrat me dramë.⁵²

Sipas kritikut Fransua Nursie: personazhi i shokut Zylo është një tartarin i dialektikës, një calik i fryrë me fjalë, një fjalëmadh i ngrehur, hipokrit, ndoshta i ndershëm, por budalla i pandershëm. Sipas kritikut Dominik Fernandez: personazhi i shokut Zylo, është i bindur për rëndësinë e detyrës së vet, gjithmonë në luftë për një përhapje më “të mirë” të kulturës, ai e percepton misionin e vet si një luftë e vazhdueshme kundër dembelëve kur hyn në zyrën e tij, atë e gjen gjithmonë në aktivitet të plotë. Ndërsa sipas Pierr Gamarra: E vërteta e personazhit është këtu, ai nuk është një kukull, i zhveshur nga ndershmëria dhe nonsensi. Pas disa diskutimeve të papëlqyeshme, disa qëndrime të shtira, zbulohet një karakter i pakundërshtueshëm njerëzor. Atëherë mund të pyesim vetën, fatkeqësitë e shokut Zylo a vijnë tamam nga kjo ndershmëri apo nga ky nonsens që i kanë mbetur dhe që e nxisin të kërkojë drejtësi? Pierr Gamar gjithashtu thekson se heroin e romanit, në të njëjtën kohë komik dhe jetësor, në të njëjtën kohë i tallur dhe tallës, e shohim si një Don Kishot të mjerë, që kalëron mbi tokën mëmë, por jo gjithnjë me naivitet... Figura e Don Kishotit është gjithnjë e mirëpritur përderisa shoku Zylo shoqërohet vazhdimisht nga një sekretar-redaktor që i rregullon mendimet e padronit të tij dhe që i bën ndonjëherë korrigjime sipas mënyrës së tij. Dhe dihet mirë se Don Kishoti dhe Sanço nuk shëtisin vetëm në hapësira të La Manshit.

Personazhi qendror i romanit, Zylo Kamberi, është një punonjës i aparatit ideologjik të pushtetit komunist. Ai drejton një sektor shumë të rëndësishëm të propagandës, pikërisht atë që lidhet me kulturën masive, ose më mirë me kulturën e masave. Për rrjedhojë, komunikimi i tij është, më së pari, një komunikim i ideologjisë. Përgjatë romanit ne shohim se veçanërisht interesi i shokut Zylo është i përqendruar te arti i fjalës, te letërsia, për shkak se edhe propaganda ideologjike te gjuha e ka mbështetjen e saj, madje kjo mëton krijimin e “gjuhës së re”.⁵³

⁵² Sinani Sh., “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit, Tiranë, 2012, f. 24

⁵³ Toska, T., “Gjuha e drurit dhe shprehësia në romanin ‘Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo’”, në: “Dritëro Agolli-personalitet i shquar i letërsisë dhe kulturës shqiptare”, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2013, fq. 320

Shoku Zylo është një figurë komike e burokratit që lufton burokratisht burokracinë mbi bazën e virtyeteve revolucionare të njësuar në mënyrë burokratike. Sipas tij, Agolli e ndërton bukur personazhin në veçanësinë e tij, duke na e paraqitur në pamjen e një burokrati kopjues të vjelur nga marrëdhëniet dhe fjalimet e shefit të vet.⁵⁴

Në të vërtetë Zylo Kamberi është një figurë tragjikomike. Veprimet e tij të bëjnë të qeshësh, po aq sa edhe të ndiesh keqardhje.

- “Si mbaroi recitimin, shoku Zylo u shkri në gaz, aq sa nxori shaminë dhe filloi të fshinte lotët. E qeshura e tij, si të ishte grip, më infektoi edhe mua. Ku i shkoi në mend ky citat! Shoku Zylo kishte ca sjellje krejt të papritura, si figurat në pozinë e futuristëve... A kishin ndonjë lidhje me atë dhe me mua vargjet e dramaturgut më të madh të kohëve? Eh, shoku Zylo, shumë herë më habiste mua, Demkën e shkretë, punëduararin kokulur!”⁵⁵

Demka: (në këtë roman na flet personazhi i Demkës) është një nëpunës i thjeshtë si shumë të tjerë në atë kohë. Ky personazh është sa qesharak, aq edhe i mjerë. Një njeri me talent, por me kalimin e kohës i nënshtrohet vullnetit të eprorit duke lënë anash dhuntinë e vet, për t’iu nënshtuar “vullnetit të detyrës”. Demka nuk e ka zotësinë magjike të kundërshtimit.

Demka është një letrar jo pa merita dhe kjo duket në kërkesat për shkrim e referate të ndryshme nga shefat e tij, që më vonë shoku Zylo i bëhet shefi kryesor. Por, Demkës talenti i tij si letrar i shkon huq, talenti i shkoi i gjithë për referatet dhe konferencat dhe u zbeh shumë. Përveç shefave, por edhe të gjithë të tjerët i kërkojnë studime e shkrime dhe ai nuk mund t’i refuzojë dhe pranon, jo sepse ai dëshiron. Kjo ndodh sepse ai nuk ka fuqi “magjike” që të kundërshtojë, pasi ai nuk arrin dot ta bëjë. Pavarësisht se thotë që herën tjetër kur dikush i kërkon t’ia punojë referatet apo edhe shkrime të tjera nuk do të përsëritë të njëjtin veprim, por ai prapë pranon. Dhe kështu referat pas referati, ai fillon ta humbasë talentin e tij letrar që e kishte, por fillon ta humbë edhe veten e tij. Faji kryesor edhe pse mundohet ta fshehë te vetja e tij. Ne si lexues mund të themi “mirë t’i bëhet”, por prapë se prapë na vjen keq për të. Të gjithë këto tregojnë se edhe Demka është një ndër viktimat e shumta të diktaturës, e cila e

⁵⁴ Rrapaj, V., “Jehona ndërkombëtare e romanit ‘Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo’”, të Dritëro Agollit, në: “Dritëro Agolli-personalitet i shquar i letërsisë dhe kulturës shqiptare”, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2013, fq. 179.

⁵⁵ Agolli, D., “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, Tiranë, 2013. fq. 104

pengon atë ta thotë që do të luftojë për veten e mendimin e tij. Pra, Demka shfaqet si një viktimë e denjë dhe jo e bindur.

Shkrimtari i pafat Demka, viktimë e inercisë së tij, por edhe e zbrazëtirës së jetës shoqërore përreth vetes, i është nënshtruar fatit të një kalemxhiu fjalimesh dhe rri e sodit tani luftën për poste e pozita në një institucion kulturor të Tiranës. Falë një fjalimi (që ia kishte shkruar Demka) veçanërisht të suksesshëm, shoku Zylo arrin të zërë një kolltuk drejtues dhe tani e tutje interesohet për gjithçka, duke filluar që nga mirëmbajtja e monumenteve e deri te hamamet e fshatrave.

Demka në roman na del sa për t'u qeshur, po aq edhe i mjerë. Me Demkën autori paralajmëron se njeriu i zakonshëm mund ta shpërngulë fajin nga vetja dhe ta gjejë një alibi, por ai që ka hyrë në botën e medimeve publike nuk ka alibi. Individit fiton aq liri sa meriton. Për skllavin e bindur më e mira është skllavëria.⁵⁶

- “U lodhe? – më thotë gruaja. Fshij me dorë ballin. Nuk e di pse më ka djersitur. U lodha, -them.
- Ndërkohë, bie zilja e telefonit. Kjo zile më therr në zemër. Matem të mos e ngre receptorin, por mekanikisht i afrohem telefonit. Kush?.. A, shoku Selman... Ç’kemi?.. Kur? Por jam i zënë, shoku Selman. Duhet ta mbaroj pasnesër.. A, për dhjetë ditë? Çfarë teme?.. Vatrata e kulturës dhe prodhimi”. Sa faqe? Pesëmbëdhjetë? A, do ta mbani në seminar?.. Mirë.. Do të bëj çmos. Natën e mirë!.. Gruaja më vështron e përvojtur. Raport?-pyet ajo. Kumtesë,-them. Shefi i arësimit dhe i kulturës e kërkon? Po, shoku Selman. A, Demkë. Pse i premtova? Ti të gjithëve u premtom. Do të sëmuresh...-thotë duke punuar me shtiza. Dhe në çast mallkoj veten: “Pse i premtova? Unë nuk e kam mbaruar raportin për drejtorinë N të ministrisë. Përsëri u ngarkova me një barrë tjetër. Ja, Adem Adashi nuk merr përsipër gjëra të tilla. Shkruan. Unë nuk kam qënë më pak i talentuar se Adem Adashi. Por shterova”. Prapë më pushton një dhimbje e thellë. Më vjen keq për veten time...”⁵⁷

Zyloja dhe Demka, shkurtime të emrave tradicionalë “Zylyftar” dhe “Demir”, ku nuk merret vesh ku fillon “modernizimi” dhe ku mbaron “përkëdhelja/ përqeshja”, e meritojnë plotësisht njëri-tjetrin. Të dy janë shkaktarë situatash që e bëjnë lexuesin të shkulet gazit, por edhe të

⁵⁶ Sinani Sh., *“Njerëzit e krisur”* të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë, 2012, f. 88.

⁵⁷ Agolli, D., *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*, Tiranë, 2013. f.f. 6-7

pezmatohet disi. Produkt i njëri-tjetrit, ata janë njëherësh bashkëfajtorë për lëngatën që e vetëvuajnë.

Për artin e humorit paraqitja e dy personazheve në bashkëfajësi është një zgjedhje e njohur botërisht. Mjafton të kujtojmë, bie fjala, lidhjet Gargantua dhe Pentagryel të Fransua Rablesë, Don Kishotin dhe Sanço Pançon në veprën e mirënjohur të Miguel Servantesit apo Lakin dhe Pocon e Beketit.

Në romanin e njohur të Servantesit në fillim Don Kishoti është krejt jashtë realitetit, në botën e iluzioneve, kurse Sanço Pança habitet me lajthitjet e të zotit. Por në fund të romanit është Sanço Pança që e humbet sensin e realitetit, duke besuar se është emëruar guvernator i një shteti, ndërsa Don Kishoti habitet me naivitetin e shqytarit të tij.⁵⁸

Arianiti: është një nga nëpunësit e thjeshtë nën vartësin e Zylos. Siç dihet nga të gjithë, duhet të sillemi mirë me drejtorët tanë dhe përpiqemi të jemi sa më të mirë edhe kur ata e kanë gabim, sepse e kërkon vendi i punës. Të gjithë nëpunësit kështu vepronin, sidomos Taqi. Por, Arianiti nuk vepronte ashtu, ishte e kundërta e Taqit. Arianiti ishte një njeri i zymtë, që nuk shihej shpesh duke qeshur apo me humor të mirë. Faktikisht humor i tij nuk ndryshonte, ai ishte gjithmonë njësoj, në një vijë të drejtë, pra ishte gjithmonë i vrazhdë në përgjigje dhe fytyra e atij gjithmonë e vranët. Por, çka është më e rëndësishmja te ky personazh është se kjo vrazhdësi nuk ndryshonte as në lidhje me shokun Zylo. Bile ndaj shokut Zylo ai përgjigjet me më shumë agresivitet. Është për t'u habitur, pasi edhe pse nuk sillej mire me Zylon, ai prapë nuk e pushon nga puna, e madje edhe nuk ankohet. Megjithatë ai ishte i vetmi njeri që ia thoshte të vërtetën në sy Zylos edhe pse me ashpërsi. Pra, i vetmi që i tregonte hapur Zylos që ishte një burokrat që nuk e meritonte postin që e mbante Zylo. Dhe në fund shohim se ishte Arianiti ai i cili emërtohet drejtor

⁵⁸ Sinani Sh., *"Njerëzit e krisur"* të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë, 2012, f.f. 88-89

Shoku Q:

Të depërtosh në thellësi të fenomeneve të jetës shpirtërore të njeriut të kohës sonë do të thotë të kuptosh zhvillimin e ardhshëm, ta përkrahësh këtë zhvillim dhe detyrë është e vështirë, por e lartë, është detyrë nderi.⁵⁹

Përshkrim i shkurtër i personazhit dytësor:

- Unë kam katranosur një biçim diskutimi, - dhe shoku Q mori nga tavolina ca tabakë letrash e filloi t'i vërtitë në duar.
- Habitem, çuditem, më lë përshtypje për diçka: Ti impresionohesh,- tha shoku Q
- Trazon, qëllon: Ajo nuk druhej nga shoku Q dhe vazhdonte të mitrolonte rërën me fjalë të nxehta.
- Organ i zgjedhur i një organizate a institucioni politik e shoqëror të rëndësishëm, që udhëheq e drejtin punën në mënyrë kolegjiale për një periudhë të caktuar kohe; përmb. Tërësia e njerëzve që bëjnë pjesë në një organ të tillë: Shoku Zylo e shoku Q ishin në presidium.⁶⁰

Shoku Shemshedin:

- Ti më mirë do të jesh me Zylon se sa me shokun Shemshedin, - tha Adila tek dëgjonim diskutantët.
- Duke përdorur aritmetikën e thjeshtë edhe në lëmin e flalëve, ne e heqim këtë pjesë subjektiviste të opinionit nga opinionit i përgjithshëm dhe atëherë mbetet ajo hise që i takon shokut Shemshedin.
- Shemshedini mund t'i ketë pasur qef hutaqët.
- Priroje për mbivlerësimin e punës mendore, të teorisë e të shkencës e përgjithësisht të punës së intelektualëve: Doemos, Shemshedini vuan edhe nga intelektualizmi.

⁵⁹ Bihiku, K., *“Probleme letrare”*, Tiranë, 1979, f. 121

⁶⁰ Agolli, D., *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*, Tiranë, 2013. f.f. 9, 13, 141, 178

- Tërësia e zakoneve të vjetëruara a e normave të vjetëruara të sjelljes; prapambetje në mënyrën e jetesës a të menduarit: Dollia duhet të zhduket si shenjë e patriarkalizmit, - tha shoku Shemshedin duke kapërcyer nga parcela eksperimentale.
- Ai që është i bredhur, që ka qarkulluar shumë; ai për të cilin është folur shumë: Kishte të drejtë i qarkulluari Shemshedin kur më pat folur për karakterin tënd të ulët.⁶¹

Zaim Avazi:

- Këto ishin attribute të referatit të shokut Zylo, attribute të thëna nga Zaim Avazi dhe Mitro Karapataqi.
- “Furtuna” mposhti avazin tënd të mëparshëm , Zaim Avazi!- tha shoku Zylo.
- Më duket se është ai karakterdobëti, kritiku Zaim Avazi!
- E qartë,-tha ngadalë Zaim Avazi dhe diçka shënoi në fletoren e tij të vogël mes mugëtirës së sallës.
- Veç asaj, të mos harrojmë se Zaim Avazi dhe Mitro Karapataqi ishin edhe polemistë të shkathët.
- Kritiku Zaim Avazi, një nga simpatizantët më të mëdhenj të shokut Zylo, bënte disa gjeste kuptimplote, duke dhënë përshtypjen se ai dinte gjithçka.
- Të dy kritikët, Mitro Karapataqi dhe Zaim Avazi, i vërtiteshin Adilës si sputnikët rreth hënës për të zbuluar ndonjë fshehtësi.⁶²

Kleopatra:

- Kleopatra e njihte forcën e saj, megjithëse nuk e nënvleftësonte edhe barikadën e parimeve të larta të shokut Zylo.

⁶¹ Agolli, D., “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, Tiranë, 2013. f.f. 18, 43, 129,132, 134, 147

⁶² Agolli, D., “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, Tiranë, 2013. f.f. 16, 159,168, 191, 193, 233

- E mërzitur dhe e pikëlluar, Kleopatra u ngrit, i hodhi një vështrim përbuzës të shoqit, i ra me pëllëmbë këllqeve dhe pulpave të bukura për të shkundur rërën dhe u largua me një krenari që kapërcente brutalitetin.
- Nuk e shihni ç'kohë mizerje është?- tha Kleopatra.
- Më me zjarr diskutonin Mitro Karapataqi dhe Kleopatra, e cila ishte shumë e informuar për çështjet që shoshiteshin buzë detit mbi kokërrzat e imta të rërës.
- Kjo është teriblë!-çirte faqet Kleopatra, por ç'është e vërteta ajo ndjente edhe një simpati të turbullt, për forcën fizike të shokut Zylo, forcë që ishte në harmoni me atë mendore.⁶³

2.2.2. Ngjarja

Ngjarjet në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” zhvillohen në periudhën kur vendi ynë ishte në një diktaturë. Në këtë roman ngjarjet fillojnë me ngritjen e shokut Zylo (Shoku Zylo, i quajtur kështu sipas zakonisht e duke u përsëritur merr një ngjyrë shumë ironike). Ky roman përshkruan ngjarje të vërteta, të cilat kanë ndodhur e janë përjetuar nga njerëzit.

Siç e cekëm edhe më lartë, romanet e D. Agollit në ndërtimin e tyre ndjekin zakonisht rrugën e subjektit me një hero qendror, me një protagonist, dhe ngjarjet vijnë e thuren rreth tij.

Ky roman trajton një nga çështjet më aktuale për atë periudhë dhe jo vetëm siç është burokracia. Ajo pasqyrohet ndërmjet personazhit kryesor, shokut Zylo (drejtor i sektorit të librit në sektorin e madh të kulturës), i cili ishte një burokrat i qetë dhe i heshtur, imponimi i tij bëhet me zë të ulët. Po ashtu, ngjarja gjithashtu pasqyrohet edhe përmes mjetit artistik kryesor satirës. Shoku Zylo (veprimet e të cilit janë gjithmonë qëllim mbara, por që e çojnë në gabime qesharake) përfaqëson të gjithë zyrtarët e lartë të cilët domosdo janë të prekur nga burokracia e nga detyrat e shumta. Të gjithë këta kanë nga një njeri të besuar, të cilit i besojnë, madje edhe fjalimet e jetës, ata më të rëndësishmit. Këta përfaqësohen nga Demka (një njeri qesharak dhe i mjerë, i cili dikur ishte njeri me talent, por me kalimin e kohës i nënshtrohet vullnetit të eprorit. Ndihmësi i shokut Zylo që në të njëjtën kohë është sekretar edhe një njeri që vihet në lojë jep llogari në mënyrë të përpiktë dhe të thatë për bëmat dhe

⁶³ Agolli, D., “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, Tiranë, 2013. f.f. 178, 194, 199, 205, 216

gjestet e tij. në detyrë dhe mbarojnë me heqjen e tij nga posti i rëndësishëm që kishte) i cili edhe pse jo me dëshirë, por me “dhembshuri” për miqtë e mëdhenj u bënë shërbime të ndryshme. Që të dy këta personazhe dhe ata që përfaqësojnë nuk mund të bëjnë pa njeri-tjetrin (ata ushqejnë njëri-tjetrin dhe nuk mund të ndahen), pra Zylo pa Demkë dhe Demkë pa Zylo nuk mund të ketë. Puna e shkresat e Zylos nuk bëjnë dot pa dobësinë e Demkës. Lufta kundër pushtetit shfaqet e trajtohet në të gjithë romanin, megjithëse në të njëjtën kohë edhe zbutet dhe theksohet nga ironia e thellë. Ky është qëllimi i autorit, me këtë roman ai godet pushtetin e atëhershëm duke u ngritur e rebeluar.

2.2.3. Mesazhi

Mesazhi kryesor i romanit “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” është lufta për të drejtat tona dhe ajo kundër atyre që i shfrytëzojnë ato. Pra, ky është një mesazh shumë i rëndësishëm për shoqërinë, ky mesazh vlen jo vetëm për atë kohë, por edhe për gjatë kohës të cilën po e jetojmë.

Pra, me këtë mesazh kuptojmë që duhet të jemi të aftë të kundërshtojmë kur na cenohet diçka si dhe të luftojmë për atë të cilën vërtet e duam.

2.2.4. Mjeti satirik: sarkazma

Sarkazma⁶⁴ - Kur ironia merr një karakter të hidhur, sulmues, kur shpreh urrejtje dhe përbuzje të thellë, kjo pra quhet sarkazëm. Mjetin satirik, sarkazmin, që është një mjet i fuqishëm poetët (ashtu siç e përdor edhe Dritëro Agolli në veprën e tij “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”) shpesh e përdorin në veprat e tyre satirike ose oratorët në ligjëratat e tyre, atëherë kur duan të demaskojnë e të godasin rëndë kundërshtarët, veset e të metat e ndryshme të një shoqërie, klasat shfrytëzuese, parazitët e ndryshëm, etj.

Figurën artistike Dritëro Agolli e përdor te ky roman. Satira në këtë roman shoqërohet pothuajse në çdo personazh, por më shumë përqendrohet te personazhi i shokut Zylo. Autori në një farë mënyre e thumbon Zylon në shumë veprime të cilat ai i bën. Situatat e ndryshme të cilat krijohen në vende të ndryshme, si në zyrë, në fshat, në plazh na bëjnë të qeshim, e

⁶⁴ Nga gr. sarkazo – kafshoj mishin.

shkaqet janë fjalët e Zylos, pra ai flet me një seriozitet të madh. Këtu vërehet qartë edhe humori i hollë i autorit. Zyloja me reagimet e tij serioze do të tregojë autoritetin e tij, por kjo e bën Zylon edhe më qesharak në sytë e të gjithë të tjerëve.

Do të thotë se kjo figurë artistike nuk e ka vetëm për qëllim që të thumbojë vetëm kryepersonazhin e këtij romani dhe karakterin e tij. Me anë të kësaj figure Dritëro Agolli godet fort të gjithë sistemin e asaj periudhe, të gjithë pushtetarët burokratë dhe hierarkiste.

2.2.5. Kritika letrare për romanin

Dominik Fernandez:

Shoku Zylo është tepër i zellshëm

“Jo Ismail Kadareja nuk është i vetmi shkrimtar shqiptar! Edhe një tjetër “pena therëse e të cilit na jep disa ide të çuditshme për jetën e vendit të tij, i cili nuk hiqet si veçanërisht liberal. Shoku Zylo (i quajtur kështu sipas zakonit e duke u përsëritur merr një ngjyrë shumë ironike), drejton seksionin e problemeve kulturore në administratën e lartë të Tiranës. Ndhimësi i tij që në të njëjtën kohë është sekretar edhe një njeri që vihet në lojë jep llogari në mënyrë të përpiktë dhe të thatë për bëmat dhe gjestet e tij. Shkëndija komike e ka burimin në paraqitjen me objektivitet të sjelljes së tij. Shoku Zylo, i bindur për rëndësinë e detyrës së vet, gjithmonë në luftë për një përhapje më “të mirë” të kulturës, ai e percepton misionin e vet si një luftë e vazhdueshme kundër dembelëve kur hyn në zyrën e tij, atë e gjen gjithmonë në aktivitet të plotë. Duhet që ai të japë mendimin e tij për gjithçka mbasi “për të nuk ka dukuri që të mos jetë pretekst për lulëzimin e mendimit të tij”. Ai dikton disa dekrete me një frymë të paimitueshme luftënxitëse. “Të studiohet me themel çështja e tragjikes. Koncepti i tragjikes, në jetën e përditshme nga pikëpamja e filozofisë së sotme socialiste, nuk duhet të ekzistonte në ndërgjegjen e inteligjencës së fshatit. Tragjikja nuk ekziston më, veçse si kategori. Gëzimi për të jetuar, ja cili është koncepti bazë.

Dritëro Agolli vërteton se nuk ka shpikur asgjë, veçse ka riprodhuar fragmente nga raporte zyrtare. Episode të shumta me shaka të cilave nuk mund t’u rezistosh. Duke vizituar një kooperativë bujqësore. Zylo është pikëlluar kur ka parë se fshatarët të përfshirë nga puna kanë harruar shqetësimet e kulturës në vend të vërë midis parantezave manitë e tij, ai këmbëngul të bëjë luftë. Kultura nuk duhet të ndjekë verbërisht grurin dhe misrin. Fshatarët a

nuk duhet të përfitojnë nga banjat publike të vëna në dispozicion të tyre? Ai e porosit sekretarin e tij t'i përgatisë një raport për rëndësinë e higjienës dhe të dobisë së ujit të ngrohtë për të hapur poret e lëkurës.

Një herë tjetër bëhej fjalë për të gjykuar një pjesë të re teatrale. Shoku Zylo shkoi në teatër dhe dha pastaj mendimin e tij. “Është një dramë e gabuar nga pikëpamja ideologjike. Fillimisht heroi negativ shpreh forcën. A e dalluat se u ngjit në majë të një kodre? Çfarë do të thotë kjo miqtë e mi? Kjo do të thotë se ai ngjitet në një pedestal, domethënë kodra. Duhet që ai të zbresë nga kodra ose duhet ta fusin në një pus. Është heroi pozitiv ai që duhet të ngjitet në kodër”. Këto sipas Agollit janë fjalë të shprehura tekstualisht nga një zyrtar i teatrit shqiptar. Shoku Zylo nuk ka fat pjesa të cilën ai e shpalli të ndaluar, u gjykua e shkëlqyer nga hierarkia e tij e lartë. Në këtë mënyrë fillon rënia e kalorësit tepër të zellshëm të kulturës.

Por para rënies së tij, ai nuk ishte antipatik për ne. Talenti i autorit është se na e tregon atë si një viktimë. Viktima e absurditetit burokrat dhe ideologjik që bën kërdrinë në vendin e tij. Një ingranazh shumë i vogël në makinën tepër të madhe anonime të shtetit...”

(Shkruar nga Dominike Fernandez në revistën franceze “Le Novs Obsever” datë 12 korrik 1990)⁶⁵

Fransua Nursie:

“‘Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo’, me titull të qartë, tregon fitoren dhe rënien në Tiranë të Zylo Kamberit, funksionar i lartë, një seksioni të çështjeve kulturore. Është një kritikë marramendëse, shumë komike e burokracisë, e dirigjimit intelektual, e privilegjeve të socializmit dhe e gjuhës së ashpër të përdorur. Botuar në revistën në vitin 1972, një vit më vonë si volum, si dhe i ribotuar më 1981, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” na detyron të rishikojmë disa nga idetë tona lidhur me lirinë që i linte një romancieri Shqipëria e Enver Hoxhës. Vend tamam misterioz! Aq më tepër mbasi pas personazheve të romanit, funksionarë shkresaxhinj, kritikë (dhe bashkëshortët e tyre, të shëndosha apo të bindura), lexuesit e paralajmëruar sigurisht mund të njihnin personalitete reale. Të pranosh se këto karikatura tallëse qenë portrete reale kjo e shton edhe më shumë habinë tonë.

⁶⁵ Zeqo, M., “*Liriku i tokës, Demoni i fjalës*”, Tiranë, 1996, f.f. 72-74

Duke imituar një formulë të famshme. Agolli është Kafka me pak më shumë diell. Ministria e Kulturës, drejtoritë, komisionarët mbledhjet e saj përbëjnë dekorin pothuajse abstrakt të një satire bufone. Zyloja është një tartarin i dialektikës, një calik i fryrë me fjalë, një fjalëmadh i ngrehur, hipokrit, ndoshta i ndershëm, por budalla i pandershëm...”

(Shkruar nga Fransua Nurise, në revistën “Figaro Magazine, datë 30 qershor 1990)⁶⁶

Denis Zherar:

Aventurat e shokut Zylo, burokrat

Një roman patetik dhe humoristik që vjen nga Shqipëria

“Shoku Zylo punon si funksionar i lartë në Ministrinë e Kulturës. Rrethi i tij, ndihmësi, gra ndihmësish, kritikë letrarë, etj., e admirojnë përparimin e tij në gjirin e administratës, përparim i arritur në sajë të fjalimeve e të raporteve të hartuara e të shprehura mirë. Pasi u bë drejtor i zyrës për problemet kulturore, Zylo filloi një udhëtim përmes vendit të tij për të parë se sa ka depërtuar kultura dhe ideologjia, të cilat ai përpiqet t’i nxisë. Atëherë në kulmin e lavdisë së tij, ai zhvillon takime interesante me fshatarë dhe kryetarë kooperativash.

I paraqitur në këtë mënyrë, romani mund të duket shumë i zakonshëm. Në të vërtetë, forca e tij qëndron në kuptimin e dyfishtë që jepet për çdo ngjarje. Drejtori i zyrës për probleme kulturore (ja një titull i bukur) shfaqet herë si një kukull groteske, herë si një funksionar patetik që zhytet në një detyrë, fundi i së cilës është në mënyrë të turbullt i errët. Këtu sigurisht qëndron arti i Dritëro Agollit i cili do të shmangë kritikën volteriane dhe të përfitojë nga një interval, kur burokracia dhe njerëzit që e krijojnë as nuk vihen në lojë dhe shihen me seriozitet. Kështu, kur Zylo arrin në postin e tij, në sajë të një shkathtësie të habitshme pasojat e së cilës i pëson ndihmësi i tij kryesor Demka, ai vendos të përtërijë tërësisht mënyrën tradicionale të trajtimit të dukurive kulturore dhe folklorike. Ai është qesharak, gjë që do ta nxjerrë në pah kontakti me popullsinë, mbasi fshatarët nuk dinë ç’të bëjnë me një të ashtuquajtur politikë kulturore, qëllimi i vërtetë i së cilës mbetet në mënyrë të habitshme i paqartë. Pushimet që merr pas këtij turneu do ta bëjnë atë të kuptojë se megjithë mithin e ngritur rreth tij, rënia nuk është larg.

⁶⁶ Zeqo, M., “*Liriku i tokës, Demoni i fjalës*”, Tiranë, 1996, f.f. 75-76

Pushtet dhe kotësi

Duke bërë përpjekje për ta vendosur veprën në një kontekst shqiptar, mund të kalohet në anën e cilësive të saj më të mira. Në drejtim “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, është një reflektim gjenial i karakterizuar nga humori dhe rëndësia për pushtetin dhe kotësinë e njerëzve. Zylo, për momentin, i ngjan shumë Adrien Deme që Albert Kohen e kishte përshkruar në veprën “Bukuria e Zotnisë”. Sigurisht toni i Agollit është kategorish i ndryshëm. Këtu, është më shumë përshtypja se po lexon një raport me një ton të akullt, gjë që nuk duket fëmijërore. Në fakt, tregimi bëhet nga Demka, ndihmësi, pothuajse sekretari i Zylos. Ai që shkruante raportet dhe përgatiste diskutimet e shefit të tij, kishte grumbulluar episode tipike të jetës së tij për të bërë pastaj një tregim, që do të përfundonte duke lënë të kuptohej se Zyloja hyn në legjendë në çastin kur ai zhduket.

Ja, megjithatë, një roman që del nga shtigje të rrahura. Fillimisht mbasi ai na bën të jetojmë në një univers të ndryshëm nga shumë pikëpamje, pastaj mbasi arrin të bashkekzistojë me finesë me humurin dhe patetikën pa zëvendësuar aspak njëri dhe tjetrin. Një libër që ia vlen ta zbulosh më shumë për vetën se sa për kureshtinë e botimit që ai përmban.”

(Marrë nga revista “Libre Belgique”, datë 23 gusht 1990, shkruar nga Denis Zherar)⁶⁷

Pierr Gamarra:

Një roman që të habit “Nga shkrimtari shqiptar Dritëro Agolli, kemi një roman sarkastik dhe që të habit “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” (Galimard) i përkthyer shumë mirë nga Kristian Gyt. Mund të merren me mend lehtë vështirësitë që ka kapërcyer me zotësinë e tij të madhe përkthyesi, tregimi dhe dialogjet plot dykuptimte, tallje të përziera me dhembshuri që duhej t’i ndjente shumë lexuesi. Na thanë se ky roman satirik ishte botuar në fashikuj në vitin 1972 në një të përjavshme shqiptare dhe se “shumë shpejtë pati suksesin më të madh, megjithë rezervat nga disa zyrtarë të lartë”. Fort mirë, për besë! Le të mos harrojmë që të theksojmë se, për mendimin tonë shokë Zylo duhet të ketë në shumë vende, me sisteme të ngjashme apo të ndryshme politike.

Kush është ky shoku Zylo? Një funksionar i lartë, i ngarkuar për çështje kulturore, një farë zoti Prydome i veshur me një farë pushteti për të përcaktuar dhe vepruar. Nga këto, ai

⁶⁷ Zeqo, M., “*Liriku i tokës, Demoni i fjalës*”, Tiranë, 1996, f.f. 83-85

ndonjëherë merr karakter komik, madhështi qesharake, ai i do ashtu si edhe ku, formulat përcaktuese në dukje, por për fat të mirë dita më e bukur e jetës së tij nuk është kordha, por do të ishte më mirë bishti i penës. Ai u rikthehet mendimeve të tij... Na jepen këtu disa faqe “Qose: njeriu që nuk ka provuar kënaqësinë e të rrojturit... Kush nuk ka dhëmbë, nuk trembet se kumbulla do t’ia mpijë ata”!

Një vërejtje këtu idetë e shokut Zylo nuk janë të gjitha të kota dhe qesharake. Një farë teprimi, një farë shakaje, përzihen me vërejtje më pak kritike. E vërteta e personazhit është këtu, ai nuk është një kukull, i zhveshur nga ndershmëria dhe nonsensi. Pas disa diskutimeve të papëlqyeshme, disa qëndrime të shtira, zbulohet një karakter i pakundërshtueshëm njerëzor. Atëherë mund të pyesim veten, fatkeqësitë e shokut Zylo a vijnë tamam nga kjo ndershmëri apo nga ky nonsens që i kanë mbetur dhe që e nxisin të kërkojë drejtësi?

Pra, ne do të ndjekim Zylon në jetën e tij, në pushime. Kështu në roman ka një sërë kapitujsh ku rrjedh natyrshëm komikja pak a shumë një satirë serioze, të tilla si “Shoku Zylo shkëlqen në mbledhjen e madhe”, “Shoku Zylo shkruan ese dhe skica për të larguar mendjen e andrallat”, “Shokun Zylo e kërkojnë me urgjencë në Tiranë”, “Shokut Zylo diçka i vjen rrotull”, etj. Po ju le ta shijoni vetë gjithë pjesën tjetër. Mbasi këto faqe kanë një shije të këndshme lokale si shija e verës apo e një fruti tipik. Por kujdes. Atje ekziston një tjetër grackë e mundshme kur beson se mburrjet e tepërta, pretendimet apo padituria e një njeriu politik sidomos në fushën kulturore, ekzistojnë vetëm në Shqipërinë pak a shumë të largët. Vepra e Dritëro Agollit na intereson edhe për vlerën e saj universale. Heroin e saj, në të njëjtën kohë komik dhe jetësor, në të njëjtën kohë i tallur dhe tallës, e shohim si një Don Kishot të mjerë, që kalëron mbi tokën mëmë, por jo gjithnjë me naivitet... Figura e Don Kishotit është gjithnjë e mirëpritur përderisa shoku Zylo shoqërohet vazhdimisht nga një sekretar-redaktor që i rregullon mendimet e padronit të tij dhe që i bën ndonjëherë korrigjime sipas mënyrës së tij. Dhe dihet mirë se Don Kishoti dhe Sanço nuk shëtisin vetëm në hapësira e La Manshit.

Ky libër qe me siguri shenja e parë e asaj që çfarë po ndodh në Shqipëri në çastin kur po shkruaj.”

(Pierr Gamar, revista “Europe” gusht 1990)⁶⁸

⁶⁸ Zeqo, M., *“Liriku i tokës, Demoni i fjalës”*, Tiranë, 1996, f.f. 86-87

Mari Fransuazë Alen:

Shqipëria pa zburime

“Si është e mundur? Një Shqipëri që nuk do të kishte tanimë një “vend prehjeje” që nuk do të ishte ajo e legjendës dhe e miteve. Një vend që do të kishte zhdukur nga kujtesa e tij edhe gjurmët e fatkeqësive. Një vend me folklor, por pa popull i pangritur. I shkatërruar nga skematizmi burokratik i një “Shoku Zylo”, me gjuhën si të vetmin thesar, por edhe kjo një gjuhë shabllone e ngurtë që shkrimtari e përdor si mjet përçmimi.

A bëhet fjalë për këto gjëra në këtë roman të Dritëro Agollit që u botua tani në Francë, ndërsa “atje” ishte botuar që prej vitit 1972? Në qoftë se po, në ç’mënyrë autori, i cili që prej 17 vjetësh drejton Lidhjen e Shkrimtarëve, mundi të sajojë një satirë kaq të ashpër ndaj regjimit, ndaj një sistemi “pa u shqetësuar” aspak? A janë mjetet e censurës në Shqipëri më të pakuptueshme dhe më paradoksale se ato që njiheshin në Lindje?

Deri tani Ismail Kadare dukej për ne unikal dhe pjesërisht në sajë të përshkrimeve të tij të gjërave monumentale, apo ndonjëherë me karakter intim të shoqërisë apo të historisë së Shqipërisë, që kjo e fundit me gjithë izolimin e saj, zinte vend në imagjinatën tonë, ushqente fantazmagoritë tona.

Del në dritë kështu një antikadare, një antifantasmagorik me një satirë të mbështetur nga sjelljet, gjuha, dogma, të cilat i pranon nomenklatura shqiptare. Por përgjegjësia fryhet, krijohet përshtypja kur është rasti se po jetohet pas perdes së vjetër të hekurt. Autori demaskon atje frymën e sistemit, simplizmin, heroi pozitiv është ai që duhet të ngjitet në kodër”, (siç thoshte Zyloja) demaskon mungesën e mirëkuptimit për të cilën dëshmojnë udhëheqësit që pretendojnë se drejtojnë “popujt” me një pikëpamje shkencore dhe filozofike “në saje të disiplinës së rrokjeve të vargut” (edhe kjo shprehje e Zylos).

Dritëro Agolli, me të cilin u takuam në Paris, mendon se “ka akoma shumë njerëz si Zyloja në Shqipëri” dhe se “të tillë do të ketë akoma edhe për shumë kohë”, por shton ai “edhe te ju ka Zylo, me ndryshimin se te ne ata dëmtojnë më shumë se te ju, mbasi jeta është e kolektivizuar”.

Pra, nuk janë “heronjtë” që autori fut në lojë, por karrieristët dhe servilët. Stili “sempel” është një ilaç kundër patosit. Megjithatë gjatë romanit satira të kujton tragjedinë, atë të një vendi që është duke devijuar.

Sigurisht është guxim i autorit në këtë konstatim që të habit. Për të djeshmen, për të sotmen. Por, edhe për të nesërmen.

Kur e pyetën në se e parashikon një kalim të mundshëm të regjimit drejt një pluralizmi demokratik, ai përgjigjet se nuk mendon që “kjo do të ndodhë në një të ardhme të afërt, për shkak të mungesës së traditës së jetës parlamentare në Shqipëri. Por, shton ai, tani ka ardhur koha të rishikohen disa aspekte në mënyrë që jeta të bëhet më demokratike, që njerëzit të flasin pa frikë.”

Fuqia e gjuhës shabllone do të jetë në rënie. Ashtu sikur ishte në rënie edhe shkëlqimi i Zylos.

(Marrë nga gazeta franceze “Le Monde Diplomatique”, korrik 1990)⁶⁹

Rekomandimi i “Zylos” nga gazetatat dhe revistat si një ndër librat më të mirë

Një libër që shuan kuriozitetin mbi Shqipërinë

“Ja një libër që do të shuaj kuriozitetin mbi Shqipërinë. Në formën e raporteve, të kronikës së jetës së Zylos, që hartohet nga ndihmësi i tij, “zezaku” i tij, shoku i tij që vihet në lojë, autori tregon me plot humor, por jo me një ofendim të vërtetë, ngjitjen dhe rënien e një funksionari të lartë, drejtor i “Zyrës për çështjet kulturore” të vendit, marrëdhënie padron-skllav në një burokraci mendjengushtë dhe të fortë.

Shoku Zylo u dallua gjatë një mbledhjeje të gjerë, nuk mund të marrë pushime, pret rapsodët, i bie dielli në kokë, thirret me ngut në Tiranë, fjalimi i fundit i shokut Zylo”... Agolli paraqet në katër pjesë dh afro 20 kapituj, jetën dhe detyrat e një prej aparatçikëve me pak të njohur në botë. Një kuriozitet ngazëllyes.”

(Marrë nga gazeta “Le Monde”, 27 gusht 1990)

⁶⁹ Zeqo, M., “Liriku i tokës, Demoni i fjalës”, Tiranë, 1996, f.f. 88-89

Pushteti politik dhe humori

“Deri tani letërsia shqiptare ishte e njohur jashtë vetëm nga veprat e Kadaresë. Toni satirik dhe singeriteti i Dritëro Agollit, i famshëm tanimë në vendin e tij, i siguroi atij sukses në Perëndim. Ai përshkruan çastet e fundit të lavdisë së Zylos, zyrtar i lartë, i rënë në fatkeqësi. Karriera e tij ritregohet nga njeriu tjetër që vihet në lojë, Demka. Aparatçiku vihet në lojë me dashamirësi për të metat e tij, ndërkohë që Demka shfaqet si një viktimë e denjë dhe jo e bindur. Është tamam rasti për autorin që të bëjë një kritikë të kujdesshme, mbasi është e maskuar, të realiteteve të vendit të vet. Për t’i shpëtuar ndikimit të pushtetit politik dhe burokratik, njeriut i mbetet humori.”

(Marrë nga gazeta “Le Pensée ruse”, 3 gusht 1990)

Roman i mprehtë djallëzor

“Më komiku dhe një nga romanet më të thella, ardhur nga vendet komuniste. I habitshëm është fakti se ai ka qenë botuar në Shqipëri... Kjo analizë e hollë djallëzore e hipokrizisë së pushteteve burokratike nëpërmjet figurës së jashtëzakonshme të drejtorit Zylo, vlen për të gjithë vendet dhe për të gjitha kohërat. Te ne, Zylo prodhohen edhe në shkollat e larta. Nuk ekziston pushtet pa një farë absurditeti.”

(Marrë nga “Le Nouveau Currier de la presse”, 23 shkurt 1990)

Nga vendi më i mbyllur i Evropës, një roman elegant

“...Nga Dritëro Agolli, një personazh me një forcë të mahnitshme njerëzore, nëpër libraritë e Italisë gjendet në shitje libri “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”. Një libër ky padyshim i veçantë. Një pasqyrë e intensitetit gati skizofrenik – shpeshherë i vështirë për të kuptuar domethënien – vendit dhe kulturës nga i cili ai rrjedh. Shqipëria është një mishul gati i padëshirueshëm i solemnitetit bizantin me fatalizmin dervishian mysliman, mbi të cilën duhet patjetër të hidhet drita e kërkimeve historike. Të dy këto komponentë-plus të tretin, kryeneqësinë e paetur katolike të Veriut të lidhur me mitin e Skënderbeut dhe simbolin e rezistencës kundrejt penetrimit ortodoks e mysliman – u mbajtën forcërisht në bashkëjetesë ato kohë nga zamke me absurde e me shkollareske marksist-leniniste. Me një mishul të tillë të

çuditshëm ideologjik bizantin fatalizëm dervishian dhe kryeneçësi katolike (plus të ashtuquajturin marksizëm-leninizëm) romani është një pasqyrë e rrallë.

Vëlla i vogël i shumë meskinëve “funksionar në karrierë” të ofruar nga letërsia e Evropës lindore, në “Shkëlqimin dhe rënien” bashkë me debatet boshe ideologjike, lojërat e mjera për pushtet dhe kortet hipokrite të spiunëve dhe përgojuesve “shoku Zylo”, është një përmbledhje e arrivistit kokëtrashë, e në të njëjtën kohë e një naiviteti të parrezikshëm, i cili i mbetet në kujtesë çdonjërit prej atyre që kanë rastin ta lexojnë këtë libër. Si një balet elegant, e i pamëshirshëm letrar midis Çehovit, Kafkës e Solxhenicinit (plus ndonjë fragment nga Lenini e Zhdanovi), padyshim që ky libër ia vlen që të lexohet...”

(Artikull i Mario Biondit në gazetën italiane “Corriere della sera”, e dielë, 23 janar 1994)

“Zylo” – në traditën e romaneve të mëdhenj (Shtypi gjerman)

“Kështu në gazetën “Die Welt” kritiku B. Kalnoky në artikullin “Të qenët shef është diçka karakteri”, shkruan: “Romani i Agollit një satirë e gjallë – pasqyron me tonin e çiltër përmes një kronikani të dëshpëruar, por të singërtë, fatin e një funksionari të fryrë, të shokut Zylo, një funksionar partie që drejton problemet e kulturës. Gjithë ai servilizëm përballë shefave të tij nuk mund ta pengojë që të ecë ngaherë i qetë edhe kur ndryshojnë rrymat politike apo edhe kur paraqiten rryma të rrezikshme nënujore. Libri, kështu bëhet në vetvete një studim i shkëlqyer e argëtues për karakterin e shefave. Kush ka një shef, do ta rigjejë atë te Zyloja.”

“Kritiku M. Verner Frank në gazetën “Der Kleine Bund” duke vlerësuar lart romanin, në artikullin “Luftë për liri e demokraci dhe një satirë” shkruan: “Bota e burokracisë nuk është pa gurë. Dhe kush pengohet në to, shpejt bie përdhe. Kështu, Zyloja, krejt papritur e sheh veten të mënjanuar, të zëvendësuar nga një shok tjetër. Dhe Demka, i cili gjithnjë përmllohet shumë për lirinë, për kohën e veprimtarisë së tij si shkrimtar, papritur u bë i lirë. Një fat me të vërtetë tragjik! Sepse Demka trembet prej lirisë, pra nuk di si ta shfrytëzojë këtë liri. Kështu, atij i bie ndërmend diçka që në situatë të tij është mundësia më e mirë: shkruan një kronikë mbi Zylon, mbi këtë unikum të përshtatur dhe mbi botën e burokracisë. Me ironi të hollë, me humor dhe shpirt, Dritëro Agolli, një ndër shkrimtarët shqiptarë më të lexuar, kritikon

intrigat, hipokrizinë, shpërdorimin e postit dhe kurthet. Dhe ai e bën të qartë, se burokracia nuk ekziston vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën”.⁷⁰

⁷⁰ Zeqo, M., *“Liriku i tokës, Demoni i fjalës”*, Tiranë, 1996, f.f. 90-101

3. Krahasimi i dy romaneve

Në vazhdim të këtij punimi do të bëhet një krahasim mes dy romaneve të Dritëro Agollit, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top”. Do t’i veçojmë karakteristikat e tyre si dhe do i analizojmë të përbashkëtat dhe ato që i veçojnë këto dy romane. Do të analizojmë strukturën e dy romaneve, si na flet autori, çfarë ndërtimi kanë, temat dhe problemet të cilat trajtohen, gjuha e cila është përdorur, ngjarjet, mesazhet e kështu me radhë.

Krijimtaria e Agollit, ashtu si gjithë letërsia jonë, shquhet për militantizmin e vet, për pasqyrimin e revolucionit tonë, të etapave të ndryshme të zhvillimit të tij. Veprat e këtij autori kanë pasur kurdoherë dhe kanë një prirje të dukshme drejt problemeve të mëdha dhe kyçe të historisë sonë kombëtare; ato vënë në qendër Luftën Nacionalçlirimtare, shndërrimet socialiste të jetës, formimin shoqëror dhe moral të njeriut, fshatin, qytetin, arat, malet.

E përbashkëta e këtyre dy romaneve është sepse, në këto dy romane ka pjesë përshkruese dhe dialoguese.

Sa i përket ngjarjes në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” tregohet në vetën e parë dhe na flet drejtpërdrejt personazhi, ndërsa në romanin “Njeriu me top” na flet drejtpërdrejt autori. Më poshtë do të paraqesim shembuj të marrë nga librat:

“Njeriu me top”:

“Pas dy ditëve filloi të binte shi me uturimë. Një shi i tillë nuk mbahej mend. Gjëmonte qielli e toka. Rrëketë e vogla zbrisnin nga bregoret me rrëmbim dhe gjersa arrinin poshtë bëheshin si përrenj. Edhe oborri i Mato Grudë ishte i mbushur me ujë dhe ishte bërë si liqen. Mato Gruda qëndronte në shkallë dhe shikonte shiun. Duke vështruar, i erdhi në mend italiani i vrarë. Pastaj mendja i shkoi tek topi dhe në shpirt ndjeu lehtësi. Pa këtij shiu gjurmët e rrotave të topit duhej të ishin fshirë nga faqja e dheut. Asnjëri nuk mund të merrte vesh se ku u zhduk e ç’u bë topi.

- *Bëri mirë që ra ky shi! Tha Mato Gruda me zë të lartë, por për vete. Zara kujtoi se i foli asaj.*
- *E ç’të mirë bëri? Na mbyti arat, atë bëri! – tha ajo*
- *I mbuloi edhe gjurmët e atij... – tha Mato Gruda.*

- Nuk i mbulon dot gjurmët e atij. Gjurmët i thelloi më shumë.
- Mos fol marrëzi! Edhe brazda sikur të ishin, do të mbuloreshin – tha Mato Gruda.
- Ç't'i bëj se nuk digjet, se do ta kisha djegur dhe do t'ia kisha mbuluar mirë gjurmët – tha Zara. ...⁷¹

“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”:

“Shoku Zylo veshi pantallonat dhe u ul në anë të krevatit me këmbë në dysHEME. Ai ndenji ashtu një copë herë pa mbathur çorapet, duke bërë: “Eh, eh!” Pas këtyre pasthirmave, diçka pëshpëriti me vete. Më në fund thirri me një ngazëllim të shtirë:

- Ngreju gjumash! Po të kishte kryetari anëtar kooperative, nuk do të shënonte ditë pune!...
- Unë hapa sytë. Shoku Zylo po mbathte çorapet.
- Pimë ca mbrëmë, ë?
- Përderisa **hun** në ziafet, do të pish, - thashë për ta qetësuar.

Ai nuk foli përnjëherësh. Shtrëngoi ballin me dorë, duke lënë çorapet gjer në gjysmën e këmbës. I vinte vështirë nga unë. E ndjeva se diçka donte të më thoshte.

- Shkoi mirë mbrëmja. Ne nuk u shkrimë me fshatarët. Nuk duhet mbajtur distancë në raste të tilla. Fshatarëve u pëlqen të sillesh me ta popullore. Më duket se nuk vepruam keq, Demkë, - tha ai
- U treguan të afërt, - thashë.
- Mua më turbulloi pak rakia. E ndjeva dhe u ngrita me kohë nga sofa, -tha ai.
- Unë mbërriva rripin e pantallonave. ...⁷²

Romanet e Dritëro Agollit në ndërtimin e tyre ndjekin zakonisht rrugën e subjektit me një hero në qendër, me një protagonist, dhe ngjarjet vijnë e thuren rreth tij. Pra, edhe në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” ka një personazh kryesor dhe është pikërisht Zylo Kamberi (konsiderohet si i tillë sepse, megjithëse nuk është ai rrëfimtari, ngjarjet

⁷¹ Agolli, D., “Njeriu me top”, Tiranë, 2000, fq. 50.

⁷² Agolli, D., “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, Tiranë, 2013, fq. 98

përqendrohen rreth tij. Gjithashtu edhe te romani “Njeriu me top” ka një hero qendror dhe ai është Mato Gruda.

Temat dhe problemet kryesore që kanë tërhequr vëmendjen e autorit, lidhen me Luftën Nacionalçlirimtare, me ndryshimet në realitetin socialist, me dashurinë për tokën dhe nënën Shqipëri, me luftën kundër moralit të huaj patriarkal e mikroborgjez dhe me pohimin e idealeve të komunizmit. Sa i përket këtyre dy romaneve, tema kryesore në romanin “Njeriu me top” është Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” vë në lojë burokracinë, hipokrizinë dhe servilizmin.

Gjuha e përdorur te këto dy romane është ajo letrare.

Ngjarjet te romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” në kohën e regjimit komunist në Shqipëri (në mënyrë të përmbledhur ngjarjet lidhen me kulmin e karrierës së shokut Zylo dhe rënien e tij nga ana profesionale), ndërsa romani “Njeriu me top” sjell një ngjarje menjëherë pas tërheqjes së ushtrisë fashiste të Musolinit dhe ardhjes së nazistëve (në mënyrë të përmbledhur ngjarjet lidhen me kryepersonaxhin Mato Gruda, një fshatar që është në hasmëri me fisin e Fizëve, e veçanërisht plakun Mere Fizi. Pas betejës së humbur, Mato Gruda gjen një top të braktisur nga ushtria italiane, Mato e fsheh topin dhe ëndërron ta përdorë kundër plakut Mere. Pas kapitullimit të Italisë fashiste, Mato merr në shtëpi një italian si rob, të cilin ai e thërret Agush dhe prej tij mëson përdorimin e topit). Te dy romanet ngjarjet tregohen në rendin kronologjik.

Në të dy romanet e Dritëro Agollit për nga ndërtimi sintaksor i fjalisë, hasim fjali të thjeshta dhe të përbëra, por më së shumti kemi fjali të përbëra.

Sa u përket mesazheve të këtyre dy romaneve janë krejtësisht të ndryshme, te “Njeriu me top” mesazhi që përcjell ky roman është bashkimi, dhe kjo është arsyeja pse ky roman merr vlerë kaq të madhe, ndërsa në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, mesazhi kryesor i romanit është lufta për të drejtat tona dhe ajo kundër atyre që i shfrytëzojnë ato, pra, ky është një mesazh shumë i rëndësishëm për shoqërinë, ky mesazh vlen jo vetëm për atë kohë, por edhe për gjatë kohës të cilën po e jetojmë. Pra, me këtë mesazh kuptojmë që duhet të jemi të aftë të kundërshtojmë kur na cenohet diçka si dhe të luftojmë për atë të cilën vërtet e duam.

Në romanet e tij “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me Top”, me kurajo të admirueshme, Agolli i jep jetë kritikës sarkastike ndaj burokracisë tek i pari, dhe përkujtimit epik dhe ironik të heroizmit partizan në luftën kundër nazifashizmit tek i dyti.

Shumica prej kritikëve, gjithashtu edhe gazetatat e shumta, bëjnë krahasime të ndryshme mes Dritëro Agollit dhe Ismail Kadaresë. Këto janë disa mendime të kritikëve:

- Alter-ego *“Ashtu si Kadareja, Dritëro Agolli i përket brezit të sakrificës, atij të viteve të plumbit e terrorit”*;
- Dominik Fernandez *“Jo Ismail Kadareja nuk është i vetmi shkrimtar shqiptar! Edhe një tjetër “pena therëse e të cilit na jep disa ide të çuditshme për jetën e vendit të tij, i cili nuk hiqet si veçanërisht liberal”*;
- Mari Fransuaz Alen *“Deri tani Ismail Kadareja dukej për ne unikal dhe pjesërisht në sajë të përshkrimeve të tij të gjërave monumentale, apo ndonjëherë me karakter intim të shoqërisë apo të historisë së Shqipërisë, që kjo e fundit me gjithë izolimin e saj, zinte vend në imagjinatën tonë, ushqente fantazmagoritë tona. Del në dritë kështu një antikadare, një antifantasmagorik me një satirë të mbështetur nga sjelljet, gjuha, dogma, të cilat i pranon nomenklatura shqiptare. Por përgjegjësia fryhet, krijohet përshtypja kur është rasti se po jetohet pas perdes së vjetër të hekurt.*

Në romanet “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top” më lart kemi përcjellë edhe me disa artikuj dhe thënie të shtypit të huaj për këto vepra. Autorë të artikujve dhe shkrimeve të tjera janë shkrimtarë dhe gazetarë mjaft të njohur si: Alen Boske, Ismail Kadare, Alter-ego: Dominik Fernandez, Fransua Nursie, Denis Zherar, Pierr Gamarra, Mari Fransuaz Alen si dhe rekomandimet e “Zylos” nga gazetatat dhe revistat si një ndër librat më të mirë. Këto shkrime besoj se i vlejnë lexuesve për të njohur jehonën e këtyre dy romaneve edhe jashtë vendit si në Francë, Gjermani, Itali, Belgjikë, Zvicër e gjetiu. “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” si dihet, është përkthyer e botuar në Francë, në Gjermani, në Itali, në Rusi, në Greqi, në Bullgari... Edhe romani “Njeriu me top” është përkthyer, por jo aq sa “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, pra romani i Zylos mund të themi se është vlerësuar më shumë nga kritikët dhe është lexuar më shumë nga njerëzit e ndryshëm. “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” del më i pëlqyer nga kritikët dhe nga gazetatat e ndryshme sesa romani “Njeriu me top”.

Te romani me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare, “Njeriu me top”, shohim që janë përdorur me vend dhe me masë fjalë të vjetëruara me vlera stilistikore. Në varësi të kohës nga e cila i

marrin ngjarjet që përshkruajnë në vepra autorët, ne gjejmë edhe raporte të ndryshme të përdorimit të historizmave ose arkaizmave. Kështu, po të ndalemi te romanet që flasin për të kaluarën e largët janë përdorur më shumë arkaizma dhe më pak historizma, te të tjerat që i drejtohen të kaluarës së afërt ose Luftës Nacionalçlirimtare ka ndodhur e kundërta. Te këto të fundit gjejmë historizma të tillë si: *njësit, gueril, etj... dhe e thërresin babanë dy fshatarë me pushkë nga ata të njësitit partizan të fshatit*.⁷³ Ndërsa te romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” gjejmë disa neologjizma të krijuara me përbërje, të cilat i përkasin stilit zyrtar administrative si: *fjalëshkëmbimi, raportshkruesi, karakterdobëti, moralprishur, mirëdashësi*.⁷⁴

Leksiku në veprën e Agollit përfshin njësi të njohura, pak të njohura a të panjohura dhe mund të vështrohet nga disa anë. Autori shquhet për njohjen e thellë leksikore e semantike të shqipes dhe ai jo vetëm i përdor fjalët shqipe me mjeshtëri, por edhe ripërtërin pasurinë e madhe që ka gjuha shqipe. Ai shquhet për njohje të thellë të mundësive dhe aftësive të mëdha të shqipes për krijimin e njësive të reja dhe vetë krijon me qindra e qindra. Gjovalin Shkurtaj shprehet: “*Dritëro Agolli fjalëkrijimin e ka si një mjeshtëri së cilës i prijnë qëmtimi e mbledhja e fjalës së bukur shqipe që ka populli dhe tradita e mëparshme letrare*”.⁷⁵

Në leksikun e prozës së tij, sidomos në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” kemi një leksik shumë të gjerë. Në të gjejmë fjalë me ngjyrim emocionues-shprehës, fjalë të zgjedhura, fjalë që tipizojnë si duhet figurat artistike, mjediset shoqërore, historizma, arkaizma dhe fjalë të krijuara nga vetë shkrimtari.

Në të dy romanet të bie në sy një numër i konsiderueshëm njësish leksikore, krijime të autorit, ndër të cilat vendin më të rëndësishëm e zënë fjalët e përbëra, kompozitat nënrenditëse dhe bashkërenditëse dhe fjalët e prejardhura me prapashtesim dhe më pak me parashtesim. Në krijimin e tyre autori ka përdorur mjete fjalëformuese të gjuhës shqipe, por edhe të huaja të cilat njihen si të tilla nga sistemi fjalëformues i gjuhës shqipe. Një nga burimet shprehëse në letërsinë artistike është krijimi i fjalëve dhe kuptimeve të reja, kjo dukuri haset edhe në veprën e Dritëro Agollit.

⁷³ Shaban, Sh., “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë, 2012, fq. 92

⁷⁴ T.Osmani, M.Gero, “Mendime për gjuhën dhe stilin e Dritëro Agollit”, Gjuha jonë, 1, Tiranë, 1991

⁷⁵ Shkurtaj, Gj., “Disa tipare të ligjërit poetik të D. Agollit”. Gazeta “Drita”, 19 prill, 1987, fq. 12.

Me anë të fjalëkrijimit ai emërton nocione të reja ose nocione të njohura, por në mënyrë të re. Kështu p.sh.shkrimtari përdor fjalë me prapashtesat –kë, ka, (ë)z, jo vetëm me kuptim zvogëlues ose përkëdhelës, por edhe me nënkuptim tallës ose nënvleftësues.

Dritëro Agolli është poeti i kohës sonë që, më shumë se kushdo tjetër, ka mundur të përfitojë nga vlerat e larmishme dhe përvoja estetike e gurrës popullore.

Mund të themi se Dritëro Agolli e vazhdon me sukses udhëtimin e tij poetik, kurse poezia e tij e ruan freskinë dhe blerimin e patharë, duke i ruajtur përherë lidhjet e forta me jetën, natyrën dhe shoqërinë.

4. Vërtetimi i hipotezave

Hipoteza 1: Në shoqërinë tonë hasim karakterin e Zylos!

Dimë se bota evoluon me kohën e bashkë me të edhe njerëzit dhe shoqëria. Por, karakteret e njerëzve në kohë nuk ndryshojnë. Mund të ndryshojnë situatat, por jo sjelljet.

Një shembull i tillë është figura e shokut Zylo Kamberit. Ai është një figurë që mund ta gjejmë të pranishëm shumë mirë edhe në ditët e sotme, jo vetëm në vendin tonë, por në mbarë botën. Pavarësisht se shoku Zylo ka jetuar në kohën e diktaturës, pra në një periudhë shumë të ndryshme nga ajo e sotmja. Ata janë njerëz që nuk kanë shumë vlera për shoqërinë. Ata merren me punë të kota, që sipas këtyre personave ato punë janë të rëndësishme, meritat nuk janë plotësisht të tyre, shpeshherë edhe komike për shkak të paditurisë apo seriozitetit e autoritetit të tepruar.

Këto persona, si puna e shokut Zylo, ishin më të shumtë e më të dukshëm në atë periudhë, por ishte e ndaluar ta shprehje mendimin dhe të flisje.

Pra, nuk është e rëndësishme periudha, sepse veset e njerëzve, sjelljet e tyre kundrejt të tjerëve apo edhe me veten, janë pothuajse të njëjta.

Zylo Kambera ka dhe do të ketë pavarësisht kohës dhe mentaliteteve.

Letërsia dhe autorët këtë qëllim kanë: me anë të veprave letrare të tyre të çfarëdo lloj periudhe të jetë mesazh për periudhën tonë dhe shoqërinë. Pra, të godasin vese të shoqërisë e të na ndërgjegjësojnë neve me anë të fjalës.

Madje sipas kritikut Mari Fransuaz Alen tregon: *“Dritëro Agolli, me të cilin u takuam në Paris, mendon se “ka akoma shumë njerëz si Zyloja në Shqipëri” dhe se “të tillë do të ketë akoma edhe për shumë kohë”, por shton ai “edhe te ju ka Zylo, me ndryshimin se te ne ata dëmtojnë më shumë se te ju, mbasi jeta është e kolektivizuar”.*” Gjithashtu edhe gazeta *“Le Nouveau Currier de la presse”* cek këtë: *“Kjo analizë e hollë djallëzore e hipokrizisë së pushteteve burokratike nëpërmjet figurës së jashtëzakonshme të drejtorit Zylo, vlen për të gjithë vendet dhe për të gjitha kohërat. Te ne, Zylo prodhohen edhe në shkollat e larta. Nuk ekziston pushtet pa një farë absurditeti.”*

- ✓ Sa i përket kësaj hipoteze, mund të themi se është vërtetuar plotësisht, pasi në shoqërinë tonë e hasim karakterin e Zylos, pavarësisht se Zylo ka jetuar në kohën e diktaturës dhe që si ai ishin të shumtë në atë kohë, por edhe në ditët e sotme e hasim këtë karakter, gjithashtu mund të themi se pavarësisht kohës dhe mentaliteteve do të ketë Zylo në shoqërinë tonë. Këtë gjë e thekson edhe vetë autori Dritëro Agolli gjatë bisedës së tij me kritikun Mari Fransuaz Alen.

Hipoteza 2: Te romani “Njeriu me top”, mesazhi kryesor është që shqiptarët t’i ndalojnë veprimet që dëmtojnë shtetin e tyre dhe veten (siç është gjakmarrja).

Mund të themi se ky mesazh është i vlefshëm në këtë roman, por që nuk është parësor. Mesazhi kryesor në këtë roman është BASHKIMI. Dhe ajo që i jep vlerat e një perle midis perlave të tjera është mesazhi i qartë i këtij romani. Një mesazh shumë i fuqishëm.

Jemi një popull i copëtuar dhe nga trangu origjinal mungojnë pjesë të mëdha të atdheut! Jemi njerëz që mbi të tëra, bota na njeh si vëllavrasës, pra, si ata që vriten kollaj me njëri tjetrin, duke përdorur Kanunin për vrasje që shpesh harrohen pas kohësh sepse e kanë bazën në shkaqe banale!

Kjo është arsyeja pse ky roman merr vlerë kaq të madhe.

BASHKIMI! Mesazhi që sillte atëherë romani, ka mbetur i patjetërsuar edhe sot!

- ✓ Mund të themi se hipoteza nr. 2 është vërtetuar pjesërisht, pasi që edhe pse ai mesazh nuk ishte parësor, prapëseprapë edhe ai ka një vlerë të mjaftueshme në këtë roman. Dhe del që, bashkimi, është mesazhi më i rëndësishëm në romanin “Njeriu me top”.

Hipoteza 3: Në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” Dritëro Agolli thumbon sistemin e asaj periudhe.

Satira në këtë roman shoqërohet pothuajse në çdo personazh, por më shumë përqendrohet te personazhi i shokut Zylo. Autori në një farë mënyre e thumbon Zylon në shumë veprime të cilat ai i bën. Situatat e ndryshme të cilat krijohen në vende të ndryshme, si në zyrë, në fshat,

në plazh na bëjnë të qeshim, e shkaqet janë fjalët e Zylos, pra ai flet me një seriozitet të madh. Këtu vërehet qartë edhe humori i hollë i autorit. Zyloja me reagimet e tij serioze do të tregojë autoritetin e tij, por kjo e bën Zylon edhe më qesharak në sytë e të gjithë të tjerëve.

Kjo figurë artistike nuk ka për qëllim të thumbojë vetëm kryepersonazhin e këtij romani dhe karakterin e tij. Me anë të kësaj figure Dritëro Agolli godet fort të gjithë sistemin e asaj periudhe, të gjithë pushtetarët burokratë dhe hierarkistë.

- ✓ Kjo hipotezë është plotësisht e vërtetuar, pasi që Dritëro Agolli satirën në këtë roman e përqendron te personazhi i Zylos dhe që kuptojmë se autori, në një farë mënyre thumbon Zylon në shumë veprime të cilat ai i bën dhe del se Dritëro Agolli satirën nuk e ka përqendruar që të thumbojë vetëm kryepersonazhin e këtij romani dhe karakterin e tij, por me anë të kësaj figure Dritëro Agolli godet fort të gjithë sistemin e asaj periudhe, të gjithë pushtetarët burokratë dhe hierarkistë.

Dritëro Agolli, një ndër shkrimtarët shqiptarë më të lexuar, kritikon intrigat, hipokrizinë, shpërdorimin e postit dhe kurthet. Dhe ai e bën të qartë se burokracia nuk ekziston vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën.

Përfundimi

Në përfundim mund të themi se, romanet e Dritëro Agollit janë një thesar i vërtetë, plot me vlera. “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top” përbëjnë një material shumë të vlefshëm për t’u analizuar dhe për t’u diskutuar.

Romanet e tij janë realiste megjithëse herë-herë kanë qenë të mbyllur në kornizën politike të realizmit socialist. Ata dallohen sidomos për skalitjen e personazheve, që janë shëmbëlltyra të gjalla të tipave të jetës shqiptare, për analizën e thellë psikologjike dhe dialogun karakterizues të tyre, për rrëfimin e natyrshëm etj.

Agolli ishte shkrimtari i filozofisë dhe i dhimbjes njerëzore, gërshetoi natyrshëm vlerat tradicionale me mënyra të reja të shprehjes artistike. Thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet krijimtaria agolliane. Në prozën e tij Dritëroi solli risi jo vetëm në strukturën narrative, por edhe në galerinë e personazheve të veta. Personazhet e Agollit janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë.

Në romanet e tij “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me Top”, me kurajo të admirueshme, Agolli i jep jetë kritikës sarkastike ndaj burokracisë tek i pari, dhe përkujtimit epik dhe ironik të heroizmit partizan në luftën kundër nazifashizmit tek i dyti.

“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” del më i pëlqyer nga kritikët dhe nga gazetatat e ndryshme sesa romani “Njeriu me top”. Shumica prej kritikëve, gjithashtu edhe gazetatat e shumta, bëjnë krahasime të ndryshme mes Dritëro Agollit dhe Ismail Kadaresë.

Sa i përket mesazheve të këtyre dy romaneve janë krejtësisht të ndryshme, te “Njeriu me top” mesazhi që përcjell ky roman është bashkimi, dhe kjo është arsyeja pse ky roman merr vlerë kaq të madhe, ndërsa në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, mesazhi kryesor i romanit është lufta për të drejtat tona dhe ajo kundër atyre që i shfrytëzojnë ato, pra, ky është një mesazh shumë i rëndësishëm për shoqërinë, ky mesazh vlen jo vetëm për atë kohë, por edhe për kohën të cilën po e jetojmë. Pra, me këtë mesazh kuptojmë që duhet të jemi të aftë të kundërshtojmë kur na cenohet diçka si dhe të luftojmë për atë të cilën vërtet e duam.

Romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” është botuar në vitin 1973. Në të cilën shkrimtari si objekt kryesor ka ndërtuar figurën e ironisë. Kjo do të thotë se kuptimi i përgjithshëm është i kundërt me atë që kumtohet drejtpërdrejt. Titulli i tij ka në qendër sintagmën shoku Zylo. Fjala shok, në sistemin socialist, kishte një kuptim moral dhe politik gjithmonë pozitiv, ndërsa në letërsi fitonte shpesh ngjyresa sublime. Agolli paraqet në katër pjesë dhe afro 20 kapituj, jetën dhe detyrat e një prej aparatçikëve me pak të njohur në botë. Dritëro Agolli, një ndër shkrimtarët shqiptarë më të lexuar, kritikon intrigat, hipokrizinë, shpërdorimin e postit dhe kurthet. Dhe ai e bën të qartë, se burokracia nuk ekziston vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën. Satira në këtë roman shoqërohet pothuajse në çdo personazh, por më shumë përqendrohet te personazhi i shokut Zylo. Autori në një farë mënyre e thumbon Zylon në shumë veprime të cilat ai i bën.

Romani “Njeriu me top” është botuar në vitin 1975, temë kryesore është lufta partizane. Në qendër të vëmendjes është hakmarrja e kryepersonazhit Mato Gruda, i cili është “në gjak” me fisin e Fizëve.

Romanet e Dritëro Agollit në ndërtimin e tyre ndjekin zakonisht rrugën e subjektit me një hero në qendër, me një protagonist, dhe ngjarjet vijnë e thuren rreth tij. Pra, edhe në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” ka një personazh kryesor dhe është pikërisht Zylo Kamberi (konsiderohet si i tillë sepse, megjithëse nuk është ai rrëfimtari, ngjarjet përqendrohen rreth tij. Gjithashtu edhe te romani “Njeriu me top” ka një hero qendror dhe ai është Mato Gruda.

Personazhet e Agollit janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë.

Temat dhe problemet kryesore që kanë tërhequr vëmendjen e autorit, lidhen me Luftën Nacionalçlirimtare, me ndryshimet në realitetin socialist, me dashurinë për tokën dhe nënën Shqipëri, me luftën kundër moralit të huaj patriarkal e mikroborgjez dhe me pohimin e idealeve të komunizmit. Sa u përket këtyre dy romaneve, tema kryesore në romanin “Njeriu me top” është Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” vë në lojë burokracinë, hipokrizinë dhe servelizmin.

Në romanet “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top” më lart kemi përcjellë edhe me disa artikuj dhe thënie të shtypit të huaj për këto vepra. Autorë të artikujve dhe shkrimeve të tjera janë shkrimtarë dhe gazetarë mjaft të njohur si: Alen Boske, Ismail Kadare,

Alter-ego: Dominik Fernandez, Fransua Nursie, Denis Zherar, Pierr Gamarra, Mari Fransuaz Alen si dhe rekomandimet e “Zylos” nga gazetatat dhe revistat si një ndër librat më të mirë. Këto shkrime besoj se u vlejné lexuesve për të njohur jehonën e këtyre dy romaneve edhe jashtë vendit si në Francë, Gjermani, Itali, Belgjikë, Zvicër e gjetiu. “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” si dihet, është përkthyer e botuar në Francë, në Gjermani, në Itali, në Rusi, në Greqi, në Bullgari... Edhe romani “Njeriu me top” është përkthyer, por jo aq sa “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, pra romani i Zylos mund të themi se është vlerësuar më shumë nga kritikët dhe është lexuar më shumë nga njerëzit e ndryshëm.

Shumica prej kritikëve, gjithashtu edhe gazetatat e shumta, bëjnë krahasime të ndryshme mes Dritëro Agollit dhe Ismail Kadaresë. Këto janë disa mendime të kritikëve: Alter-ego “*Ashtu si Kadareja, Dritëro Agolli i përket brezit të sakrificës, asaj të viteve të plumbit e terrorit*”; Dominik Fernandez “*Jo Ismail Kadareja nuk është i vetmi shkrimtar shqiptar! Edhe një tjetër “pena therëse e të cilit na jep disa ide të çuditshme për jetën e vendit të tij, i cili nuk hiqet si veçanërisht liberal*”; Mari Fransuaz Alen “*Deri tani Ismail Kadare dukej për ne unikal dhe pjesërisht në sajë të përshkrimeve të tij të gjërave monumentale, apo ndonjëherë me karakter intim të shoqërisë apo të historisë së Shqipërisë, që kjo e fundit me gjithë izolimin e saj, zinte vend në imagjinatën tonë, ushqente fantazmagoritë tona. Del në dritë kështu një antikadare, një antifantasmagorik me një satirë të mbështetur nga sjelljet, gjuha, dogma, të cilat i pranon nomenklatura shqiptare. Por përgjegjësia fryhet, krijohet përshtypja kur është rasti se po jetohet pas perdes së vjetër të hekurt.*

Te romani me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare, “Njeriu me top”, shohim që janë përdorur me vend dhe me masë fjalë të vjetëruara me vlera stilistikore. Në varësi të kohës nga e cila i marrin ngjarjet që përshkruajnë në vepra autorët, ne gjejmë edhe raporte të ndryshme të përdorimit të historizmave ose arkaizmave.

Kështu, po të ndalemi te romanet që flasin për të kaluarën e largët janë përdorur më shumë arkaizma dhe më pak historizma, te të tjerat që i drejtohen të kaluarës së afërt ose Luftës Nacionalçlirimtare ka ndodhur e kundërta. Te këto të fundit gjejmë historizma të tillë si: *njësit, gueril, etj... dhe e thërresin babanë dy fshatarë me pushkë nga ata të njësitit partizan të fshatit.*⁷⁶ Ndërsa te romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” gjejmë disa neologjizma të

⁷⁶ Shaban, Sh., “Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë, 2012, fq. 92

krijuara me përbërje, të cilat i përkasin stilit zyrtar administrativ si: *fjalëshkëmbimi, raportshkruesi, karakterdobëti, moralprishur, mirëdashësi*.⁷⁷

⁷⁷ T.Osmani, M.Gero, *"Mendime për gjuhën dhe stilin e Dritëro Agollit"*, Gjuha jonë, 1, Tiranë, 1991

Bibliografia

Libra:

1. Agolli, Dritëro, *“Disa probleme të poezisë së letrarëve të rinj”*. “Nëntori”, Tiranë 1964, nr. 7.
2. Agolli, Dritëro, *“Njeriu me top”*, Tiranë, 2000.
3. Agolli, Dritëro, *“Poezi”*, Tiranë, 1981.
4. Agolli, Dritëro, *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*, Tiranë, 2013.
5. Ece Delioğlu, *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” - përkthyer në turqisht*, 2018
6. Bihiku, Koço, *“Probleme letrare”*, Tiranë, 1979.
7. Brahimi, Razi, *“Kur flasim për poezinë”*, Tiranë, 1972.
8. Budini, Belina, *“Dritëroi rrëfen aventurat e Zylos”*, gazeta: “Shekulli”, 17 shtator 2000.
9. E.Lafe, *“Ditëro Agolli, mjeshtër i fjalës shqipe”*, “Telegraf”, 13 tetor 2011.
10. Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, 1980,
11. Klara Kodra, *“Bota poetike e Dritëro Agollit”*, revistën Studime filologjike, 2012/1-2.
12. Kuçuku, Bashkim, *“Bota poetike e Dritëro Agollit”*, në revistën Studime filologjike, 1991/1
13. Rene, Welek & Austin, Warren, *“Teoria e letërsisë”*, Tiranë, 2007.
14. Rrapai, Vjollca, *“Jehona ndërkombëtare e romanit ‘Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo’” të Dritëro Agollit*, në: “Dritëro Agolli-personalitet i shquar i letërsisë dhe kulturës shqiptare”, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2013.
15. Rrokaj, Shezai, *“Çështje të gjuhës shqipe I”*, Albatros, Tiranë, 2007.
16. Sinani Shaban, *“Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit*, Naimi, Tiranë, 2012.

17. Shkurtaj, Gjovalin, *“Disa tipare të ligjërimet poetik të D. Agollit”*. Gazeta “Drita”, 19 prill, 1987.
18. T.Osmani, M.Gero, *“Mendime për gjuhën dhe stilin e Dritëro Agollit”*, Gjuha jonë, 1, Tiranë, 1991
19. Toska, Teuta, *“Gjuha e drurit dhe shprehësia në romanin ‘Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo’”*, në: *“Dritëro Agolli-personalitet i shquar i letërsisë dhe kulturës shqiptare”*, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2013
20. Thomai, J., *“Rreth prejardhjes semantike të fjalëve në gjuhën shqipe”*, f. 150.
21. Uçi, Alfred, *“Problem i mitit në letërsinë e realizimit socialist”*. “Nëntori”, 1980, numër 3.
22. Universiteti “Eqrem Çabej”, *“Dritëro Agolli- Personalitet i shquar i letërsisë dhe kulturës shqiptare”*, Gjirokastër, 2013.
23. Veber, Max, *“Politika si profesion”*, Asdreni, Shkup, 2006.
24. Vinca, Agim, *“Orët e poezisë”*, Prishtinë, 2010.
25. Zeqo, Moikom, *“Liriku i tokës, Demoni i fjalës”*, Tiranë, 1996.
26. Anesti, Naçi, *“ITALIA, ITALIANËT DHE ITALIANITETI NË LETËRSINË SHQIPTARE TË PERIUDHËS SË KOMUNIZMIT”*, AKTET Vol. VI, Nr 4, 2013, fq. 363

Linqe:

27. <http://telegraf.al/kulture/njeriu-me-top-magjeps-gjeneven/> (qasja e fundit 10.11.2018)
28. http://www.oranews.tv/article/urime-e-cmime-ne-prag-te-pervjetorit-dritero-agolli-merr-carlo-levi-ne-82-vjetor?fbclid=IwAR0CBADMiU5GZ6HSGoAhCDgTrE3_6_53GhceweTnweGQoAnj0PyS2AIolPw
29. https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-2 (qasja e fundit më 10.10.2018)

30. https://sq.wikipedia.org/wiki/Drit%C3%ABro_Agolli#cite_note-GjSh-4 (qasja e fundit më 01.11.2018)
31. https://sq.wikipedia.org/wiki/Shk%C3%ABlqimi_dhe_r%C3%ABnia_e_shokut_Zylo (qasja e fundit më 15.11.2018)
32. <https://www.voal.ch/shkelqimi-dhe-renia-e-shokut-zylo-dhe-alibia-e-estetit-alfred-ucit-dritero-agolli-kunder-realizmit-socialist-nga-mexhit-prenci/?fbclid=IwAR3olrLhqDLSjbGuv2oa8UaK4IJs0ghJiM3JTUwtVAzIlWuyvW1PnNswm4> (qasja e fundit më 10.11.2018)
33. <http://quarterlyconversation.com/peter-constantine-on-njeriu-me-top-the-man-with-a-gun-by-dritro-agolli>